

**Dorëzohet
amendamentet
e para për
ndryshimin
e emrit**

Fq.3



**DIVORCET NË
MAQEDONI**
Një e katërta e të
shkurorëzuarve
janë shqiptarë

Fq.4




**Politika
maki-
aveliste**
Forum

Fq.11



Koha



**KOHA për
anigma**

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE XII · Numri 3494 · e shtunë-e diel, 27-28 tetor 2018

4°C 19°C

15 DEN

FORUM

**Kurbani
i "pajtimit"**



Larg asaj që misioni pajtimtar i Talat Xhaferit të jetë i atyre përmasave të faljes së gjaqeve ndër shqiptarët, sepse tash duhet të falen vepra të bëra si rezultat devijimesh e keqpërdorimesh të pushtetit. Të gjitha mënyrat tjera u provuan, po nuk pati sukses, ka mbetur që kjo, që politika të bëjë kurban shtetin juridik për hir të "interesave madhore" Fq.10

KULTURË

**Mid'hat
Frashëri:
Shqipëria
do të bëhet
një kafene
e madhe!**

Fq.18

RAJON

**Korrigjimi i
kufijve nuk
duhet të
përrjashtohet
nga bisedimet**

Fq.16



NDËRMARRJET SHTETËRORE DHE KOMUNAT

NË BORXHE, POR ME VETURA LUKSOZE



Të dhënat e fundit të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë për të Hyra Publike (DHP) tregojnë se komunat dhe shumë ndërmarrje publike, shkolla fillore dhe të mesme... përfundimisht me muajin shtator të këtij viti kanë borxh total prej 305 milionë euro

Fq.7

Ekspertë pa licencë te ekspertiza e "Opel Omegës"

Shkup, 26 tetor - Ekspertiza e veturës "Opel Omega", njëra prej dëshmiave kyçe kundër të akuzuarve, është realizuar nga persona ekspertë pa licencë. Të punësuarit e MPB-së, respektivisht pjesëtarët e laboratorit për krim-teknikë në kuadër të kësaj ministrie, të premtën përsëri dëshmuar për mënyrën se si janë mbledhur gjurmët nga vetura, me të cilën supozohej se janë larguar vrasësit e pesëfishit. Personi ek-

spert, Pavlina Daneva Stefanovska, në përgjigjen e dhënë avokatit Naser Raufi, tha se me licencë është pajisur në vitin 2015. Kësisoj, ajo e pranoi se më 13 prill të vitit 2012, kur është kryer kontrolli i veturës "Opel Omega", ajo dhe kolegët e saj nuk kanë pasur licenca. Megjithatë, pala mbrojtëse në seancë nuk e kontestoi këtë ekspertizë biologjike të Stefanovskës, por kërkoi sqarime...

Fq.5



EDITORIAL

PAMJAFTUESHMËRIA E KULTURËS GJUHËSORE



Emin AZEMI

Në Maqedoni ka edhe shumë punë për t'u bërë që gjuha shqipe të del nga kallëpet e politikës së ditës. Ajo, mbi të gjitha, ka nevojë për një trajtim më serioz nga gazetarët, studentët, politikanët dhe përgjithësisht nga intelektualët. Vetëm si e tillë, gjuha shqipe e arsyeton epitetin e të qenit guardian i identitetit kombëtar, sepse në të kundërtën mund të ndodhë që nëpër dyert e lëna shkretë të në hyjnë ndikime të ndryshme kulturore e gjuhësore, me në kosto shumë të lartë për vetë të ardhmen tonë

Shumë flitet për përpjekjet politike që shqipja të ketë status të barabartë të gjuhës zyrtare në Maqedoni, por fare pak flitet se cili është kujdesi ynë ndaj saj në komunikimin publik, në variantin shkruar apo të folur. Teknologjizimi i komunikimit tonë i ka dëbuar letrat nga kutitë postare dhe vendin e tyre e kanë zënë sms-të, të shkruar me një gjuhë të çregullt dhe aspak në frymën e shqipes. Edhe e-letrat që i dërgojmë përmes postës elektronike vuajnë nga ngutja për të kapur termet kohorë, ndërkohë që arkivat e nesërme do të zbulojnë shkallë të lartë analfabetizmi kolektiv në kulturën tone të shkrimit.

Gjuha mësohet në shkollë dhe kultivohet në komunikimin e zakonshëm, qoftë në raporte private, apo shoqërore-publike.

Një gjuhë mund të konsiderohet e kultivuar vetëm atëherë kur përdoret e saj i respektojnë normat bazë mbi të cilën është ngritur arkitektura gramatikore-sinatskore i asaj gjuhe. Gjuha shqipe është mjaft e pasur, kurse kultura e përdorimit të saj ka qenë e lidhur me historinë e shkrimit.

Aktualisht përdoruesit e gjuhës shqipe nuk tregojnë ndonjë kujdes të duhur që ajo të trajtohet si një thesar që identifikon vlerat kulturore e shpirtërore të tyre. Pamjaftueshmëria e trajtimit të gjuhës shqipe edhe si aset kulturor, duke e reduktuar atë në teknikalitet burokratik, flet për vetëdijen e pamjaftueshme që kemi ndaj kësaj gjuhe. Kjo qasje ka ardhur parasegjithash si rezultat i mosimponimit të kulturës së gjuhës nga vetë ata që e shkruajnë në media, që e përdorin në institucione dhe që e mësojnë në shkollë.

Nëse vazhdojmë ta trajtojmë gjuhën shqipe si emergjencë burokratike, pa kujdesin që duhet treguar ndaj saj në planin e kulturës shkrimore e foljore, atëherë nuk mund të themi se po i arsyetojmë përpjekjet tona që po i bëjmë për avancimin e saj kundruall gjuhëve të tjera. Gjuha shqipe edhe në të kaluarën ka pasur peripetie e saj, sidomos gjatë pushtimeve të huaja, por vetëdija e lartë kulturore e kombëtare e intelektualëve shqiptarë tejkalonte këto peripeci. Në këtë mënyrë gjuha shqipe arriti të bëhet kod unifikues i prirjeve të ndryshme fetare e krahinore të shqiptarëve, duke demonstruar para botës së qytetëruar një sens të zhvilluar të kujdesit ndaj asaj që një popull e bën të ketë identitetin e vetin. Në Maqedoni ka edhe shumë punë për t'u bërë që gjuha shqipe të del nga kallëpet e politikës së ditës. Ajo, mbi të gjitha, ka nevojë për një trajtim më serioz nga gazetarët, studentët, politikanët dhe përgjithësisht nga intelektualët. Vetëm si e tillë, gjuha shqipe e arsyeton epitetin e të qenit guardian i identitetit kombëtar, sepse në të kundërtën mund të ndodhë që nëpër dyert e lëna shkretë të në hyjnë ndikime të ndryshme kulturore e gjuhësore, me në kosto shumë të lartë për vetë të ardhmen tonë.


KUR SHQIPTARËT NË MAQEDONI MUND TË KËRKOJNË TË DREJTËN E VETËVENDOSJES?

"Ish ministri i punëve të jashtme Denko Maleski (91-93) dhe përfaqësues i Maqedonisë në OKB (93-97) i porositi shqiptarët që në këtë fazë të mos propozojnë asgjë.

Epo kur duhet ta bëjnë këtë, pasi të përfundojë procesi i rrumbullaksimit të shtetit etnik maqedonas me përbërje multietnike?

Në kuadër të propozimeve qeveritare s'ka vend, por ka hapësirë në "pajtimin kombëtar".

Por, megjithatë, Në pesë vitet e ardhshme, në rast se statusi juridik i shqiptarëve të Maqedonisë nuk do të ndryshojë dhe qeveria qendrore nuk do të jetë e gatshme t'i pranojë kërkesat legjitime dhe demokratike të popullatës etnike shqiptare, atëherë ngushtimi i hapësirës do t'i detyrojë shqiptarët etnikë të shfrytëzojnë të drejtën e vetëvendosjes (Jus Cogens) si një ndër principet kardinale të ligjit ndërkombëtar", ka shkruar një status analisti i çështjeve gjeopolitike Selim Ibrahim.



BUKURIA SI MALL, JO SI HYJNIZIM!

"Shqiptarët janë të obsesionuar pas bukurisë fizike dhe sipërfaqes së dukshme. Mjaft të vështrosh mënyrën se si flasin politikanët dhe mediat për bukurinë. Ajo konceptohet si mall, jo si hyjnzim, sepse përbaltja është më e lehtë të realizohet kur bukuria, konceptohet si domate për tu ngrënë dhe jo si konturim i një pikturë të plotë që nis nga mendja, virtutet, eleganca, sharmi, vendosmeria dhe koherenca", ka shkruar në profilin e saj në Facebook, gazetaria dhe shkrimtarja nga Tirana, Mira Tuci.



NË VEND TË VIZAVE, LIBERALIZIM POSTES!

"Duke qenë politikë mëhallash, e natyrshme që secili turret ta kapë një copë pushtet. Kjo logjika 'kazakistançe' e emërimit me lehtësi të padrueshme në poste publike është trasuar më herët nga të gjitha pushtetet pararendëse. Prandaj ekzistojnë sintagmat: pushteti i Drenicës, Dukagjinit, Llapit. I vetmi toponim politik që nuk është etablu në leksikon politik të kësaj kohe është Rrafshi i Kosovës. Mbese koha që gjeografia politike të pasurohet edhe me një nocion, i cili shpërfaqë esencën e problemit: shteti i Kosovës trajtohet si plaçkë lufte. Secili në mënyrë e vet ia ndukë nga një copë. Kosova është karma e shumë njerëzve të veshur me imunitet politik, ama vësh për vete!", ka shkruar në Facebook, gazetari nga Prishtina, Bekim Kupina.



MEDIACity

PA KOSOVËN NË INTERPOL, SIGURIA NË BALLKAN S'DO TË JETË STABILE

Çështja e pranimit të Kosovës në Interpol sërisht është aktualizuar në prag të Asamblesë së Përgjithshme në nëntor, ndërsa anëtarësimi eventual i saj është ose "rrezik i paprecedentë", ose "kontribut në luftën kundër kriminalitetit ndërkombëtar, varësisht nga ajo se a pyetet Beogradi apo Prishtina.

Ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli i tha BBC-së se arsye kryesore për hyrjen e Kosovës në Interpol janë lufta kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar, bashkëpunimi ndërkombëtar, marrja e përgjegjësisë së plotë për bashkëpunim dhe konfigurimin i sigurisë në Ballkan, që sipas tij pa Kosovën nuk do të jetë i plotë, ndërsa rajoni nuk do të jetë stabil. Beogradi kundërshton anëtarësimin eventual të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare. Anëtarësimi i Kosovës në Interpol do të ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, me Rezolutën 1244 dhe do të shkaktoje pasoja negative për dialogun midis Beogradit e Prishtinës.

Interpoli, rikujton Beogradi, vjet ka miratuar Rezolutën sipas të cilës vendet që kërkojnë anëtarësim duhet të jenë anëtare të OKB ose të kenë statusin e vëzhguesit. Po ashtu thekson se institucionet e Prishtinës nuk janë në gjendje të mbajnë sigurinë në Kosovë dhe se hyrja e Kosovës në Interpol do të përdorej për revanshizëm ndaj pjesëtarëve të policisë e të ushtrisë së Serbisë, që kanë marrë pjesë në luftën e vitit 1999. Deri tash në urdhër-arrestet e Interpolit për shkak të krimeve të luftës ka qenë shefi i Agjencisë së Sigurimit Ushtarak, Momir Stojanović, ndërsa fletarrestet të Interpolit në bazë të urdhrave të gjykatave serbe gjithsej janë shqiptarë nga Kosova, të dyshuar për krime lufte. Ndër ta është edhe presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, por aktualisht urdhër-arrestet ndaj tyre tash për tash janë "të padukshme". Sivjet duket se Kosova ka mbështetje të mjaftueshme, së paku për futjen e kësaj çështjeje në rend të ditës për votim. Marko Kmeziq, ligjërues dhe hulumtues në Qendërën për Studime të Europës Juglindore në Cracë, konsideron se kjo çështje është me rëndësi "për bashkëpunimin ndërkombëtar policor". Ai thekson edhe se nëse Serbia merr qëndrim obstruktiv ndaj kësaj çështjeje, kjo do të mund të ketë ndikim negativ në vazhdimin e dialogut midis Beogradit e Prishtinës dhe largimin nga integrimet europiane.

(BBC, 26 tetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

"KUSH MARTOHET HERËT, RREZIKON DIVORCIN"

Femrat që presin deri në moshën 26-vjeçare për t'u martuar kanë mundësi më të madhe për një martesë jetëgjatë. Ato të cilat për herë të parë janë martuar shumë më të reja, rreth moshës 45 vjeç kanë gjasa të divorcohen. Të paktën kështu thonë statistikat e prestigjiozes "Time". Sipas të dhënave të Regjistrat të Punës, numri më i madh i divorceve është mes femrave që janë martuar

rreth moshës 15-20 vjeç. Të dhënat janë analizuar nga sociologu i Universitetit të Maryland, Philip Cohen. Mesatarisht këto martesë që quhen edhe si "martesat e fillimit" zgjasin një vit deri në 10 vjet. Një tjetër studim i 2015 thoshte se mosha ideale për njerëzit që të kenë një martesë të gjatë dhe të suksesshme është mes 28-32 vjeç.

KUSHTETUTA, PUSHTETI E PRET VMRO-në

DORËZOHET AMENDAMENTET E PARA PËR NDRYSHIMIN E EMRIT

Nevojitet nga tre ditë për një amendament në Komisionin parlamentar dhe më vonë - edhe në seancë plenare. "Nëse të gjitha amendamentet, ato që i dimë dhe i presim të dorëzohen, kjo do të marrë rreth dy muaj e gjysmë për procesin kompleks", ka thënë Kiracovski

Koha Evis HALILI

Shkup, 26 tetor - Një pjesë e projekt-amendamenteve kushtetuese dje i janë dorëzuar Parlamentit të Maqedonisë, ndërsa procedura do të fillojë të realizohet nga e hëna e tutje. Kështu ka paralajmëruar deputeti dhe sekretari i përgjithshëm i LSDM-së, Aleksandar Kiracovski, sipas të cilit, nevojitet nga tre ditë për një amendament në Komisionin parlamentar dhe më vonë - edhe në seancë plenare. "Nëse të gjitha amendamentet, ato që i dimë dhe i presim të dorëzohen, kjo do të marrë rreth dy muaj e gjysmë për procesin kompleks. Shpresoj dhe jam i bindur se të gjithë deputetët në mënyrë integruese do të marrin pjesë në debatin për



amendamentet e parashtruara, që janë evidente dhe të gjitha së bashku ta rumbullakojmë procesin që na çon drejt BE-së dhe NATO-s", tha Kiracovski. Ai pret që të formohet edhe një Komision për pajtim dhe bashkim nacional dhe i ftoi të gjitha grupet parlamentare të marrin pjesë në të.

Në ndërkohë, nga Qeveria informojnë se projekt-amendamentet tjera të Kushtetutës për të cilat vijon afati që del nga vendimi i së premtes të Parlamentit, janë në fazë të përgatitjes. Bëhen përpjekje që në konsultime për përgatitjen e tyre që të kryen edhe deputetë nga VMRO, por tash për tash kjo nuk do të ndodh. Megjithatë, projekt amendamentet do të mund të gjenden në Parlament për fundjavë ose nga e hëna. Nga grupi i deputetëve të LSDM-së

thonë se lihet kohë për inkuadrimin e deputetëve nga opozita në konsultime, edhe pse shprehin pesimizëm se kjo do të ndodh. Nëse kjo nuk ndodh, në konsultime, thonë nga atje, do të kryet eventualisht grupi i ri i deputetëve që u përjashtuan nga VMRO-DPMNE.

Nga kjo e fundit nuk ka informacione konkrete se me të vërtetë deputetët e tyre nuk duan të kryen në konsultimet për projekt-amendamentet kushtetuese. Nga partia opozitare theksojnë se së shpejti do të merret vendim si partia do të veprojnë lidhur me këtë çështje. Vendimin do ta sjellin në marrëveshje me deputetët. Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, lidhur me paralajmërimin për konsultime për përgatitje të projekt-amendamenteve të Kushtetutës, thotë se obligimi i propozuesit është që të përgatitë

Projekt-amendamente, por është e pakontestueshme të bëhen konsultime paraprakisht lidhur me idenë midis deputetëve dhe Qeverisë. Kjo nuk është përjashtuar si mundësi, potencoi Xhaferi, ndërsa nuk tregoi kohën se kur do të fillojnë konsultimet që u paralajmëruan nga kryeministri Zoran Zaev.

"Nuk do të thotë patjetër sot konkretisht. Qeveria mori afat adekuat prej 15 ditëve me konkluzionin e Parlamentit gjatë miratimit të vendimit dhe duhet ta respektojnë këtë afat, ndërsa se nëse do të fillojnë sot ose nesër, ose pasnesër ky është tanimë vendim i tyre", tha Xhaferi. Ndryshe, kryeministri Zaev të mërkurën theksoi se mbetet i hapur për inkuadrimit të opozitës në pjesën e sugjerimeve për përfundimin identitetit, garancinë e përcaktimit dhe votimin në Greqi.



Trajanovi propozon Deklaratë për pajtim kombëtar

Shkup 26 tetor - Lidhja Demokratike e Pavle Trajanovit konsideron se pajtim midis të majtëve dhe të djathtëve, si dhe pajtim me të gjerë kombëtar, duhet të zhvillohet përmes Parlamentit me sjelljen e të ashtuquajturës "Deklaratë për pajtim kombëtar".

Në Deklaratë, siç thuhet në njoftimin e Lidhjes Demokratike, duhet të përmenden arsyet dhe nevoja e pajtimit, qëllimet strategjike për të cilat nuk ka nevojë për konfrontim, por konsensus dhe unitet, siç janë karakteri unitar i shtetit, integriteti territorial, integritet euroatlantike, sundimi i ligjit, sistemi shumëpartiak dhe ngjashëm.

"Me këtë Deklaratë duhet të parashikohet rehabilitimi dhe kompensimi i viktimave të sistemit njëpartiak dhe pas tij, rinovim i proceseve të montuara politiko-gjyqësore, rikshikim i lustracionit të selektuar dhe të padrejtë, privatizimi të padrejtë etj. Ndryshe, pajtimi nuk duhet të përzihet me idetë për amnistinë nga përgjegjësia penale e bartësve të politikave të larta dhe funksioneve shtetërore, ndërsa në kontekst të proceseve integruese dhe anëtarësimit në NATO", njofton partia e Trajanovit.

Marrëveshja e Prespës do të kalojë në

Parlamentin e Greqisë

Shkup, 26 tetor - Marrëveshja e Prespës kur të arrijë për shqyrtim në Kuvendin grek nuk do të dënohet, ka theksuar zëvendës ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë, Nikolaos Kvik gjatë takimit të djeshëm me kolegun e tij nga Maqedonia, Andrej Zhernovski. "Konsideroj se pas miratimit tek ju, kur të arrijë para Kuvendit grek do të kalojë menjëherë", ka deklaruar Kvik pas takimit. Nga Ministria e Punëve të Jashtme të Maqedonisë informojnë se dy bashkëbiseduesit janë pajtuar se besimi dhe miqësia midis dy palëve po thellohet dhe se marrëveshjen për zgjidhje të çështjes së emrit, ju vihet fund dallimeve të cilët i vështirësojnë marrëdhëniet miqësore midis fqinjëve. Bashkëbiseduesit kanë shprehur shpresë se i gjithë procesi i paraparë me marrëveshjen do të përfundojë me sukses në të dy vendet dhe se etapa tjetër do të jetë bashkëpunimi në NATO Aleancën si dy vende aleatë, të cilët qëndrojnë në tryezë të përbashkët dhe në institucionet e Bashkimit Evropian. Kvik është anëtar i partisë "Grekët pavarur" të Panos Kamenos, partnerit të koalicionit të SYRIZA-s.

ISH-KRYEMINISTRI E PRANON AKTIN E UDHËZIMIT

DERI MË 8 NËNTOR GRUEVSKI DUHET TË PARAQITET NË BURG

Shkup, 26 tetor - Ish-kryeministri Nikolla Gruevski dje në Gjykatën Penale pranoi aktin e udhëzimit që më së voni deri më 8 nëntor duhet të paraqitet në burg për vuajtjen e dënimit me burg për furnizimin e mercedesit luksoz. Nga Gjykata Penale informojnë se akti i udhëzimit për vuajtjen e dënimit Gruevskit i është shqiptuar sot në gjykatë, sepse nuk e kishin gjetur në adresën e shtëpisë. Sipas aktit të udhëzimit, ai duhet të lajmërohet në burg në afat prej 13-të ditëve nga dita kur i është shqiptuar akti.

Gjykata e Apelit në Shkup në datën 5 të këtij muaji si të pabazë e refuzoi ankesën e Gruevskit për lëndën "Tanku" dhe në tërësi e konfirmoi aktgjykimin e shkallës



së parë për dënimin me burg prej dy viteve. Gjykata pjesërisht e pranoi ankesën e të akuzuarit ish-ndihmës i ministrit të Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski dhe e ndryshoi pjesën e vendimit për dënimin dhe e dënoi me burg në

kohëzgjatje prej katër viteve dhe gjashtë muajve, ndërsa në pjesën e mbetur vendimin e shkallës së parë e konfirmoi.

Gjykata Penale më 23 maj të këtij viti për furnizimin e "mercedesit" luksoz në vlerë prej 600

mijë eurove, e dënoi të akuzuarin e parë Gjoko Popovskin me gjashtë vite e gjashtë muaj, ndërsa të akuzuarin e dytë Nikolla Gruevskin si nxitës për kryerjen e veprës me dy vite burg. Të dy dorëzuan ankesa për aktgjykimin e shkallës së parë deri te Gjykata e Apelit Shkup.

Në lëndën "Tanku" e dënuar është edhe ish-ministria e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska me gjashtë vite burg. Gjatë furnizimit të "mercedesit" zyrtar, Jankullovska e kishite keqpërdoruar pozitën dhe autorizimin zyrtar me çka ishte dëmtuar edhe procedura e tenderit sepse ishte favorizuar një operator ekonomik. Ish-ministria ishte gjykuar veçmas pas lindjes.

Thujse një e katërta e divorceve në Maqedoni ndodh tek çiftet shqiptare, ose rreth 500 shkurorëzime në vit. Ajo që bie në sy është se gjatë katër viteve të fundit ruhet një numër konstant, nga 521 divorce në 2013 në 489 vitin e kaluar

DIBRA ME NORMËN MË TË LARTË TË DIVORCEVE

NJË E KATËRTA E TË SHKURO- RËZUARVE JANË SHQIPTARË

Koha

Evis HALILI

Shkup, 26 tetor - Nëse vite më parë bashkëshortët i "ndante vdekja", viteve të fundit dhënia fund e bashkëjetesës mes një çifti nuk konsiderohet si tabu, madje as në qytetet më të vogla. Dibra është një prej komunave me prelevancën më të lartë të divorceve mes komunave shqiptare. Edhe pse numri i shkurorëzimeve gjatë një viti i evidentuar në zyrat e gjendjes civile nuk është i madh (39 në total) krahasuar me komunat e tjera, si Tetova ku në vit ndodhin 88 divorce, norma e shkurorëzimeve mbetet e lartë - 236.4 në qytetin ku ndodhin jo më shumë se 139 kurorëzime në vit.

Kjo normë është shumë më e lartë edhe se mesatarja e divorceve në rang vendi - 145 divorce në 1000 martesë. Thujse një e katërta e divorceve në Maqedoni ndodh tek çiftet shqiptare, ose rreth 500 shkurorëzime në vit. Ajo që bie në sy është se gjatë katër viteve të fundit ruhet numri konstant, nga 521 divorce në 2013 në 489 vitin e kaluar. Tetova është komuna ku shënohet edhe numri më i madh i bashkëshortësive që zgjedhin këtë formë për t'i dhënë fund martesës, por kjo komunë radhitet e katërta mes komunave shqiptare sa i takon shkallës së divorceve në 1000 martesë, për shkak se Tetova është komuna ku ndodh edhe numri më i madh i martesave gjatë një viti në rang vendi (785 kurora).

Sa i takon divorceve, shkalla e tyre është



112 divorce në 1000 martesë. Në statistikat zyrtare nuk jepen arsyet e shkurorëzimeve, ndërsa në zyrat e gjendjes civile pohojnë se nuk përjashtohen rastet kur divorcet mes çiftëve shqiptarë në shumë raste janë edhe fiktive dhe bëhen për shkaqe emigrimi dhe sigurimin e dokumenteve në një shtet të huaj. Struga është një tjetër komunë që radhitet e dyta për shkallën e divorceve (165.3 divorce në 1000 martesë), po ashtu edhe Zhelina (153 divorce në 1000 martesë), ndërsa komuna të tilla si Haraçina apo Studeniçani kanë jo vetëm shkallë shumë të ulët të divorceve, por edhe të numrit të tyre gjatë një viti. Në Maqedoni, gjatë një viti ndodhin rreth dy mijë divorce, kryesisht gjatë katër viteve të para të martesës dhe

rreth 60 për qind e tyre regjistrohen në çiftet maqedonase.

Karakteristikë për muajin kur ndodhin divorcet është dhjetori dhe më pak në muajin gusht. Mesatarja e normës së divorceve në rang vendi është 145 në 1000 martesë, ndërsa si komuna me normën më të lartë janë Bogdanci 339.3 Zërnovci 454.5 apo Ohri 297.9. Ndarjet e çifteve përveçse konsiderohen si një proces i vështirë për vetë familjet, prej disa vitesh po ndikojnë negativisht në pasqyrën e përgjithshme të vitalitetit të popullsisë. Gjatë katër viteve të fundit numri i divorceve ka një reduktim shumë të vogël, ndërsa numri i martesave është në rënie.

"Shpëtimi" vjen nga komunat shqiptar-

NORMA E SHKURORËZIMEVE NË KOMUNAT SHQIPTARE

Dibër: 236.4 divorce në 1000 martesë
Strugë: 165.3 divorce në 1000 martesë
Zhelinë: 153 divorce në 1000 martesë
Tetovë: 112 divorce në 1000 martesë
Tearcë: 108.4 divorce në 1000 martesë
Gostivar: 107 divorce në 1000 martesë
Haraçinë: 19.8 divorce në 1000 martesë

NUMRI I DIVORCEVE NË KOMUNAT SHQIPTARE VITI 2017

Tetovë: 88 shkurorëzime
Strugë: 83 shkurorëzime
Gostivari: 81 shkurorëzime
Dibër: 39 shkurorëzime
Çair: 39 shkurorëzime
Likovë: 17 shkurorëzime
Haraçinë: 2 shkurorëzime

re, si Tetova, e cila renditet e para për shifrat e larta të martesave të evidentuara, që rriten vazhdimisht çdo vit (90 martesë më shumë në vitin 2017) dhe që përbëjnë rreth 6 për qind të numrit të përgjithshëm të tyre. Në total gjatë vitit të kaluar janë regjistruar rreth 14 mijë martesë, shifër kjo që është 4.4 për qind më e lartë sesa një vit më parë.

ANULOHE SEANCA PËR INCIDENTIN E 5 PRILLIT

INCIDENTI NË REÇICË, KËRKOHET DËSHMITAR I MBROJTUR

"Avokatët e palës tjetër kanë dhënë një kërkesë për dëshmitarë të mbrojtur dhe gjykata ende nuk ka vendosur. Ne menduam se sot do të mbahet seanca dhe se do të ketë një vendim. Edhe ne si avokat mendojmë se për dëshmitarë të mbrojtur nuk ka bazë, meqë në bazë të Ligjit, dihet se kur dhe në cilën fazë kërkohet dëshmitari i mbrojtur", tha Asani



shkëmbimit të zjarrit mes dy grupeve nga Kumanova ku kishte edhe të plagosur. Lajmin e kanë konfirmuar avokatët e dy palëve të involvuara në këtë incident. Avokati i të akuzuarve, Elenko Milanov, ka konfirmuar se seanca gjyqësore është anuluar për shkak se të akuzuarit nuk kanë mundur të sillen në gjykatë.

"Për shkaqe teknike, burgu i Idrizovës nuk ka mundur të sjellë të

akuzuarit dhe ajo ishte arsyeja që seanca u anulua. Gjykimi momentalisht është në procedurë të prezantimit të fakteve", tha ai. Milanov nuk ka dhënë hollësi se pse është kërkuar që të ketë edhe dëshmitarë të mbrojtur në këtë gjykim. "E tërë kjo do të diskutohet kur do të mbahet seanca. Gjykata jep termine të shkurtra duke patur parasysh se bëhet fjalë për të lëndë parahetimore, prandaj edhe presim

që kjo të mos zgjasë shumë gjatë", deklaroi ai. Në ndërkohë, avokati i palës mbrojtëse Miralem Asani, po ashtu ka konfirmuar se seanca është anuluar për shkaqe teknike dhe pret që shumë shpejt të ketë epilog. Ai ka thënë kërkesa e avokatëve të palës tjetër për dëshmitarë të mbrojtur nuk ka bazë.

"Avokatët e palës tjetër kanë dhënë një kërkesë për dëshmitarë të mbrojtur dhe gjykata ende nuk ka vendosur. Ne menduam se sot do të mbahet seanca dhe se do të ketë një vendim. Edhe ne si avokat mendojmë se për dëshmitarë të mbrojtur nuk ka bazë, meqë në bazë të Ligjit, dihet se kur dhe në cilën fazë kërkohet dëshmitari i mbrojtur", tha Asani. Ai më tej sqaroi se në këtë rast nuk ka vend për dëshmitarë të mbrojtur, sepse të gjitha faktet dhe provat janë marrë dhe tash është rishqyrtimi i të njëjtave. Në seancën e parë, katër të akuzuarit: Ridvan Dervishi, Sabit Rexhepi, Halil Kamberi dhe Lulzim Biti nga Shqipëria kanë pranuar

akuzën për incidentin në Reçicë të Vogël që ka ndodhur më 5 prill të këtij viti, ku edhe mbeti i vrarë Naip Rexhepi. Këta katër persona akuzohen për pjesëmarrje në rrahje. Të tjerët akuzohen për vrasje, tentim-vrasje dhe pjesëmarrje në rrahje. Paraprakisht, Prokuroria Themelore Publike e Tetovës kishte ngritur akuzë kundër 13 personave për pjesëmarrje në incidentin e armatosur, ku jetën e humbi Naip Rexhepi, ndërsa u plagos Florim Misini. Seanca e radhës për këtë incident është caktuar për më 11 korrik. Prokuroria e Tetovës paraprakisht kishte ngritur akuzë kundër 13 personave për pjesëmarrje në incidentin e armatosur e që kishte ndodhur jo larg selisë së BDI-së. Sipas informacioneve që qarkullojnë në opinion, incidenti ka ndodhur për shkak të mosmarrëveshjeve për drejtimin e Degës së BDI-së në Kumanovë. Seanca e radhës është caktuar për më 9 nëntor me fillim në orën 10 në Gjykatën Themelore në Tetovë.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 26 tetor - Për shkaqe teknike, të premtën është anuluar seanca gjyqësore në Gjykatën Themelore të Tetovës për incidentin në Reçicë të Vogël që ndodhi më 5 prill kur një person mbeti i vrarë gjatë

RIGJYKIMI I "MONSTRËS" VAZHDON ME DETAJET E VJETRA

EKSPERTË PA LICENCË KANË KRYER EKSPERTIZËN E "OPEL OMEGËS"

Ekspertja e krim-teknikës, Pavlina Stefanovski pranoi se në vitin tre vite pas vrasjes së pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës ka fituar licencë si ekspertë, ndërsa ekspertizën e veturës e ka bërë në një garazh në MPB dhe jo në vendin e ngjarjes ku është gjetur vetura, ku edhe rëndom bëhen ekspertizat. Atëkohë, ajo tha se nuk i ka parë monedhat dhe dëshmitë tjera që u gjetën disa vite më pas



realizuar në kuadër të një garazhe brenda MPB-së. Paraprakisht veturën nuk e kam parë. Por, më 13 prill të vitit 2012, kemi filluar të realizojmë ADN-analizë në brendësi të veturës. Procedurën për gjetjen e gjurmëve biologjike e kemi realizuar unë dhe një kolege e imja, e cila tashmë është në pension. Si rezultat i këtyre hetimeve, kemi konstatuar se gjurmë biologjike ekzistojnë në katër lokacione brenda hapësirës së veturës 'Opel Omega' edhe atë në: karriçen e pasme nga ana e djathtë, në pjesën e mbështetësit të kokës, pa-staj tek dorëza e derës së pasme nga ana e majtë, po ashtu tek dorëza e djathtë e derës së shoqëruesit të shoferit. Këto gjurmë biologjike janë të ndryshme njëra me tjetrën", tha Stefanovska.

Prezantimin e tij në gjykatë, të premtën e bëri edhe shefi i laboratorisë së krim-teknikës në MPB, Rober Janevski, sipas të cilit, gjatë kërkimit të ADN-profileve në veturën "Opel Omega", është gjetur ADN profili i të akuzuarit Alil Demiri (në arrati), i cili paraprakisht ka qenë i evidentuar në data bazën e policisë.

"E pamundur është të ekzistojnë persona tjetër me këtë ADN-profil, vetëm nëse Alili nuk ka vëlla binjak, gjegjësisht klon nga ai", tha Janevski, i cili mes tje-

Prezantimin e tij në gjykatë, të premtën e bëri edhe shefi i laboratorisë së krim-teknikës në MPB, Rober Janevski, sipas të cilit, gjatë kërkimit të ADN-profileve në veturën "Opel Omega", është gjetur ADN profili i të akuzuarit Alil Demiri (në arrati), i cili paraprakisht ka qenë i evidentuar në data bazën e policisë



rash është edhe person përgjegjës për gjenetikë në MPB.

Avokati Naser Raufi në seancën e fundit për rastin "Monstra", i mbështetur në monedhat e zbuluara së fundmi në veturën "Opel Omega", pyeti personat ekspertë që kanë realizuar ekspertizën e kësaj veturë, nëse më 13 prill të vitit 2012, i kanë vërejtur këto monedha dhe vallë ndaj tyre është kryer ekspertizë. Në këtë rast, ekspertja Pavlina Daneva Stefanovska, tha se ajo as që i ka parë dhe aq më pak ka kryer ekspertizë ndaj të njëjtave.

Gjatë ripërsëritjes së ekspertizës, e cila paraprakisht është prezantuar në Gjykatën Penale të Shkupit, mes tjerash dëshmitarët ka ekspertë potencuan se në kuadër të MPB-së, gjegjësisht në laboratorin për krim-teknikë ekziston data bazë me të gjitha ADN-profilet e zbuluara në veturën "Opel Omega". Mes tjerash, ata thanë se veprimet e tyre kryesisht mbështeten

në urdhëresa. Ndryshe, dilemat e familjarëve të të akuzuarve qëndrojnë pikërisht mbi çështjen se kush e ka kontrolluar veturën para se ajo të dorëzohet për ekspertizë, pse personat ekspertë nuk e kanë kryer ekspertizën në vendin ngjarjes ku është gjetur vetura apo në vendin e ngjarjes ku është kryer krimi. Ndonëse familjarët e të akuzuarve për vrasjen e pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës nuk e shprehin zhgënjimin dhe faktin se ky proces po zvarritet ngjashëm si ai i "Sopotit", ata thonë se nëse Prokuroria Speciale Publike nuk fillon me prezantimin e "bombave" për këtë lëndë, gjasat janë shumë të mëdha që ky gjykim të vazhdojë deri në pafundësi. Sidoqoftë, nga PSP deri më tani nuk kanë dhënë asnjë shenjë se kur pritet të prezantohen fakte dhe dëshmi të reja për rastin "Monstra", pasi deri më tani - gjykimin e procedojnë në bazë të aktakuzës së ngritur nga Prokuroria për krim të organizuar.

KRONIKË

Kapen me kokainë, arrestohen tetovarët

Pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, të enjten nga ora 17.00 deri ora 18.00, kanë kryer bastisje në shtëpinë dhe hapësirat ndihmëse të 62 vjeçarit M.S. nga Tetova, në rrugën "108" në Tetovë. Gjatë bastisjes, e cila është kryer me urdhër të gjykatësit, në një tavolinë prej druri është gjetur kokainë, një peshore digjitale, një pjatë me mbetje të materies pluhur i bardhë, si dhe një lugë metalike. Gjësendet e gjetura janë fotodokumentuar dhe marrë për ekspertizë, kurse pronari M.C, biri i tij B.C. 40-vjeçar, si dhe personi F.A. 57-vjeç, të cilët kanë qenë në hapësirat ndihmëse të shtëpisë në garazhë, janë privuar nga liria, ndërsa B.C është ndaluar në Stacionin policorë Tetovë për procedurë të mëturtyshme. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Zjarr në një banesë në lagjen "Prolet"

Një zjarr shpërtheu paradite në një banesë në rrugën "Nikolla Karev" në lagjen "Prolet" (Pranvera). Nga Njësia Zjarrfikëse Territoriale e Qytetit të Shkupit informojnë se zjarri është raportuar rreth orës 11 dhe se kanë intervenuar me tre automjetet dhe tetë zjarrfikës. Zjarri është shuar rreth orës 12:20.

Lëndohen dy minatorë në Toranicë

V.M. (41) nga fshati Duraçka Reka dhe N.S. (40) nga Kriva Pallanka, minatorë në minierën Toranicë afër Kriva Pallankës janë lënduar dje nga rreshqitja e dheut gjatë minimimit të një miniere. Siç kumtoi MPB-ja, dje rreth orës 14:40 në Shtëpinë ligjvënësore Kriva Pallankë që të dy janë sjellë për dhënien të ndihmës mjekësore. Është kryer ekspertizë në vendin e ngjarjes nga ana e shërbimeve të policisë, inspektorëve të punës, një inspektor shtetëror të minierave dhe një përfaqësuesi të minierës. (U.H)

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 26 tetor - Ekspertiza e veturës "Opel Omega", njëra prej dëshmiave kyçe kundër të akuzuarve, është realizuar nga persona ekspertë pa licencë. Të punësuarit e MPB-së, respektivisht pjesëtarët e laboratorit për krim-teknikë në kuadër të kësaj ministrie, të premtën përsëri i dëshmuar për mënyrën se si janë mbledhur gjurmët nga vetura, me të cilën supozohet se janë larguar vrasësit e pesëfishtë. Personi ekspert, Pavlina Daneva Stefanovska, në përgjigjen e dhënë avokatit Naser Raufi, tha se me licencë është pajisur në vitin 2015. Kësisoj, ajo e pranoi se më 13 prill të vitit 2012, kur është kryer kontrolli i veturës "Opel Omega", ajo dhe kolegët e saj nuk kanë pasur licencë. Megjithatë, e pala mbrojtëse në seancë nuk e kontestoi këtë ekspertizë biologjike të Stefanovskës, por kërkoi sqarime për faktin se kush i ka urdhëruar të bëjnë ekspertizën e veturës, si dhe në cilin vend është kryer ajo.

"Kemi vepruar në bazë të urdhërësës së gjykatësit të procedurës hetuese. Ekspertizën e kemi

Transportojnë udhëtarë pa frena të rregullta

Tetovë, 26 tetor - Në bazë të aktiviteteve të Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, të cilat në kontinuitet janë duke u ndërmarrë për siguri më të madhe në transportin publik të udhëtarëve, të enjten nga ora 09 deri ora 13 është realizuar kontroll-aksion.

Gjatë kontrollit në qytetin e Tetovës, janë kontrolluar 60 au-

tomjete, gjegjësisht autobusë, kombi furgon dhe taksit vetura, nga të cilët 46 automjete me urdhër të policisë janë dërguar për kontroll të jashtëzakonshëm teknik, ku 10 automjete kanë pasur pajisje të parregullta të frenimit, ndërsa dy vetura nuk janë paraqitur në Stacionin për kontroll teknik. Dhjetë veturat të cilat kanë qenë tekniki-

sht të parregullta, menjëherë janë larguar me urdhër të policisë nga trafiku, ndërsa për 12 vetura janë përgatitur flatëpaguesa për kundërvajtje.

Ndërkohë, gjatë kontrollit në Gostivarit, janë zbuluar gjashtë automjete, të cilat kanë qarkulluar në trafik me pajisje të parregullta të frenimit, derisa dy nuk janë pa-

raqitur në Stacionin për kontroll teknik.

Gjashtë veturat me pajisje të parregullta të frenimit menjëherë janë larguar me urdhër të policisë nga trafiku, kurse janë përgatitur gjithsej 10 gjoba adekuate. Gjopa për parregullsi teknike arrin në 400 euro, në kundërvlerë të denarit. (U.H)

NGEC TRECTIA PËRMES INTERNETIT

NJË E PESTA E POPULLATËS BLEN ONLAJN

Edhe përkundër një sërë treguesish për potencialin e madh të tregtisë onlajn, Maqedonia në raport me të gjitha shtetet e tjera, ka vetëm 20 për qind të blerësve onlajn nga totali i popullatës që kanë qasje në internet



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 26 tetor - Maqedonia në letër është tërësisht e gatshme për tregtinë elektronike si pjesë e digjitalizimit të jetesës dhe ekonomisë, mirëpo në praktikë - renditet ndër të fundit në Evropë me vetëm një të pestën e popullatës që harxhon të holla për bleje përmes internetit.

Kryetarja e Shoqatës së tregtisë elektronike, Nina Angellovska, thotë se qytetarët e Maqedonisë në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti kanë harxhuar 63 milionë euro në tregtinë elektronike që paraqet rritje për 20 për qind në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sipas saj, pjesa më e madhe e këtyre transakcioneve apo gati 41 milionë euro, ka përfunduar te tregtarët e huaj onlajn, ndërsa 22 milionë euro kanë qarkulluar tregtarët vendor.

"Maqedonia në letër ka një sërë faktorësh që tregojnë se duhet të ketë sukses më të madh lidhur me tregtinë elektronike, duke filluar nga zgjerimi me 74 për qind i internetit në shtet, më shumë kartela të lëshuara se sa kemi banorë, server të sigurt, siguri të dorëzimit postar e kështu me radhë. Mirëpo, edhe përkundër një sërë treguesish për potencialin e madh të tregtisë onlajn, Maqedonia në raport me të gjitha shtetet e tjera, ka vetëm 20 për qind të blerësve onlajn nga totali i popullatës që kanë qasje në internet", informoi Angellovska.

Sipas saj, për këtë nivel të ulët mund të ekzistojnë më shumë shkaqe siç është mungesa e ofertës më të mirë, preferenca e pagesës me para të gatshme në dorë, niveli i ulët i posedimit të shkathtësisë të ndryshme kompjuterike etj.

Në ndërkohë, ministri i Shoqërisë Informatike, Damjan Mançevski, thotë se digjitalizimi më nuk është çështje e zgjedhjes, por nevojë dhe realitet i kohës moderne që e jetojmë. "Andaj, në këtë drejtim para nesh kemi sfida të mëdha që duhet të zgjidhen nga e tërë shoqëria, për shkak se kjo do të ndryshojë si mënyrën e jetesës, ashtu edhe mënyrën e udhëheqjes së biznesit", theksoi Mançevski në hapjen e konferencës së parë kushtuar tregtisë elektronike në Maqedoni.

Sipas tij, në këtë drejtim së shpejti do të lëshohet në përdorim edhe portali i ri për shërbime të ndryshme onlajn.

"Patjetër duhet dhe mundemi të angazhohemi së bashku për promovimin e tregtisë elektronike ndaj konsumatorëve, sidomos përmes

rritjes së vetëdijes së qytetarëve për përfitimet. Qytetarët duhet të jenë të sigurt se përgjatë procesit të tregtisë elektronike, të dhënat e tyre janë të sigurta, ndërsa transakcionet të garantuara. Në të kontekst kemi punuar fuqishëm edhe për strategjinë e sigurisë sajber, ndërsa në fazën përfundimtare është edhe plani aksional për sigurinë në internet", theksoi ai.

Sipas tij, Maqedonia po ec përpara në digjitalizim, ndërsa rezultatet e para të këtij transformimi, qytetarët do të mund ti ndiejnë në fillim të vitit 2019, kur do të vendoset në funksion portali kombëtar për shërbime elektronike, si dhe regjistri elektronik. Me fjalë të tjera do të krijohet katalog i të gjitha shërbimeve administrative për qy-

DAMJAN MANÇEVSKI

Qytetarët duhet të jenë të sigurt se përgjatë procesit të tregtisë elektronike, të dhënat e tyre janë të sigurta, ndërsa transakcionet të garantuara. Në të kontekst kemi punuar fuqishëm edhe për strategjinë e sigurisë sajber, ndërsa në fazën përfundimtare është edhe plani aksional për sigurinë në internet

tetarët dhe firmat, ku të interesuarit mund të fitojnë informacion për çdo shërbim në një vend të vetëm.

Nga Fondi i Inovacionit dhe Zhvillimit Teknologjik thonë se ekzistojnë më shumë projekte që i financojnë lidhur me digjitalizimin, e që parashikojnë mënyra të reja të depërimit të prodhimeve dhe shërbimeve deri tek konsumatorët.

"Përkrahja në pjesën e inovacioneve ndoshta me fokus të veçantë në tregtinë elektronike do të vazhdojë edhe në vitin 2019. Jemi në përgatitje e sipër të thirrjeve të reja publike ku totali, sipas planit të punës për vitin 2019 i Fondit, është 12.5 milionë euro", theksoi Jovan Despotovski, drejtori i Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik. Ndryshe, në konferencë morën pjesë mbi 370 pjesëmarrës nga 120 kompani, shtatë banka, organizata, institucione, fakultete e kështu me radhë.

HULUMTIM I RI I ASOCIACIONIT "AGTIS"

QYTETARËT S'KANË BESIM NË KAPACITETET E QEVERISË PËR REFORMA

Shkup, 26 tetor - Një hulumtim i realizuar nga Asociacioni për Bashkëpunim dhe Tolerancë Qytetare (AGTIS) ka nxjerr në pak se Qeveria e Maqedonisë "nuk është të realizojë reformat të cilat i janë vendosur si detyrë në rrugën e integritimit evropian, megjithëse angazhohet në realizimin e tyre". Në anketën e realizuar nga AGTIS, në njëjërën anë 49 për qind e të anketuarve thonë se pushteti angazhohet për realizimin reformave, por në anën tjetër 48 për qind e të anketuarve thonë se qeveria aktuale nuk ka kapacitet për t'i realizuar të njëjtat. Aleksandar Cvetkoski nga ky asociacion konsideron se ndërhyrja e politikës në çdo pore të institucioneve, paralizon funksionimin e institucioneve me kapacitet të plotë për t'i realizuar reformat në sistemin gjyqësor, atë të shëndetësisë, arsimit dhe ekonomisë.

"Pa Regjistrimin e popullsisë së Maqedonisë nuk mund të reali-



zohen reformat. E dyta, pushteti duhet të koncentrohet në luftën kundër korrupsionit, sepse qytetarët e kanë vendosur luftën kundër korrupsionit si prioritet mbi nevojën e reformat në gjyqësor dhe shëndetësi arsimit etj".

"Dhe treta, institucionet duhet të punojnë në përforsimin e kapaciteteve profesionale për realizimin e reformave", thotë Cvetkoski. Qyte-

tarët e Maqedonisë konsiderojnë se realizimi i reformave kryesisht ka të bëjë me rritjen e numrit në administratë, madje 43 për qind e të anketuarve vlerësojnë se reformat lidhen me rritjen e numrit të punësuarve në institucionet e pushtetit vendor dhe atij lokal.

Ndërkaq, Borçe Davitkoski ligjërues në Universitetin e Shkupit, i angazhuar në më shumë raste për

rritur administrata dhe qytetarët gjithnjë e më pak janë të kënaqur nga cilësia e shërbimeve. Pse është kjo kështu? Sepse çelësin kryesor për punësim në administratë e mbanë qeveria dhe puna në administratë llogaritet si më fitimprurësja dhe jo si punë me përgjegjshmëri", thotë Davitkoski.

Përderisa njohësi i çështjeve politike, Sasho Ordonacki thotë se qytetarët e Maqedonisë edhe kundrejt faktit që i vlerësojnë pozitivisht hapat e guximshëm të qeverisë në drejtim të realizimit të reformave, megjithatë ata si shumë problematike e kanë detektuar mungesën e llogaridhënies. Në anketë, 38 për qind e respondentëve janë shprehur se referendumin për Marrëveshjen e emrit nuk ka paraqitur pengesë për realizimin e reformave, kundrejt 37 për qind të tjerëve që kanë vlerësuar se reformat janë zvarritur për shkak të referendunit. (REL)

NDËRMARRJET SHTETËRORE DHE KOMUNAT

NË BORXHE, POR ME VETURA LUKSOZE

Të dhënat e fundit të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë për të Hyra Publike (DHP) tregojnë se komunat dhe shumë ndërmarrje publike, shkolla fillore dhe të mesme... përfundimisht me muajin shtator të këtij viti kanë borxh total prej 305 milionë euro



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 26 tetor - Në Maqedoni gjithçka është e mundur. Ndërmarrjet shtetërore dhe komunat vazhdojnë të jenë borxhlinj më të mëdhenj ndaj sektorit publik dhe sektorit privat.

Edhe pse në arken e tyre nuk kanë para të mjaftueshme për pagesa të faturave komunale dhe rrogave në kohë për të punësuarit, si dhe borxhe deri në fyt, në anën tjetër nuk heqin dorë nga blerja e veturave luksoze për nevojat e drejtorëve dhe kryetarëve të komunave, vlerë kjo që madje kalon shifrën prej 80.000 euro për veturë.

Të dhënat e fundit të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë për të Hyra Publike (DHP) tregojnë se

komunat dhe shumë ndërmarrje publike, shkolla fillore dhe të mesme... përfundimisht me muajin shtator të këtij viti kanë borxh total prej 305 milionë euro. Pjesa më e madhe janë borxhe të cilët një kohë të gjatë sektori privat i kërkon nga institucionet shtetërore në vlerë prej 163 milionë euro. Ndërsa vlera e borxhit që institucionet shtetërore u kanë ndërmarrjeve publike për shërbime komunale si ngrohje, komunikim dhe transport, kap vlerën prej 118 milionë, borxh ky që bie mbi komunat.

Ministria e Financave informoi se borxhliu numër 1 është kompania me kapital shtetëror "Hekurudhat e Maqedonisë - Transporti" në vlerë prej 46 milionë euro. Borxhliu i dytë më i madh është

Komuna e Ohrit me borxh prej 15.7 milionë euro. Në vendin e tretë është ndërmarrja për ujëra atmosferike dhe Komuna e Strugës me borxh prej 14.4 milionë euro, ndërsa vendi i katërt i takon Klinikës universitare dhe qendrës për urgjencë në vlerë prej 12.6 milionë euro. Vendi i pestë i takon Radiotelevizionit të Maqedonisë me borxh prej 8.6 milionë euro. Përveç Komunës së Ohrit dhe Tetovës, me borxh prej 10.9 milionë euro është edhe Komuna e Karposhit. Përveç borxhit që kanë ndaj sektorit privat dhe ndërmarrjeve publike, këto tri komuna borxhe kanë edhe ndaj peronave fizik edhe kompanive vendit.

Jashtë vendit, ndërmarrjet shtetërore kanë borxh në vlerë prej

23.9 milionë euro, ndërsa ndaj qytetarëve vlera e përgjithshme e borxhit është 1.3 milionë euro. Është hera e parë që publikohen kaq të dhëna të detajuara për borxhet që kanë institucionet shtetërore e ku qartë shihet se një numër i madh i institucioneve, kanë telashe të mëdha sa i përket kthimit të borxheve të mbetura. Një pjesë e madhe e borxhlinjeve janë shkollat, të cilët vazhdojnë funksionimin me llogari bankare të bllokuara. Megjithatë, luksi i ëktyre borxhlinjeve nuk ka fund. Analiza e fundit e Qendrës për Komunikim me Qytetarët tregon se institucionet shtetërore dhe pushteti lokal së bashku posedojnë gjithsej 2645 vetura, prej të cilëve 2008 janë blerë më çmim furni-

zues prej 33 milionë euro, ndërsa për 637 vetura - institucionet nuk kanë të dhëna se më çfarë çmimi furnizues janë blerë. "Të gjitha ministrinë, përfshirë dhe Qeverinë e Maqedonisë në disponim kanë 2215 vetura që kanë vlerë totale prej 27.2 milionë euro, derisa komunat për momentin posedojnë 430 vetura në vlerë prej 5.7 milionë euro", thuhet në analizën e Qendrës për Komunikim me Qytetarët. Në anën tjetër, me veturë më të shtrenjtë në vlerë prej 77.839 euro vozitet kryetari i Komunës së Sveti Nikollës dhe kryetari i Kavadarit në vlerë prej 70.075 euro. Kryetari Dibrës vozitet me veturë të re në vlerë prej 49.000 euro, ndërsa kryetari i Strugës vozitet me veturë të llojit "Audi A6 kuatro" në vlerë prej 68.247 euro. Po ashtu, kryetari i Gostivarit në posedim ka veturën e llojit "Audi A6" në vlerë 65.595 euro, ndërsa kryetari i Demir Kapisë në vitin 2014 ka blerë veturë të re të llojit "Pasar 2.0 TDI" në vlerë prej 62.656 euro. Komuna e Ohrit dhe Karposhit, dy komuna këto që kanë borxhe rekorde të paguara të faturave komunale dhe rrogave, kanë harxhuar 293 mijë euro për 13 vetura të blera, konkretisht 303 mkijë euro për 16 vetura të reja. Kryetari i Komunës së Strugës për blerjen e shtatë veturave ka harxhuar 206 mijë euro, ndërsa çmimi mesatar për blerjen e këtyre veturave nga komunat kap shifrën prej 15.051 euro.

KONFERENCË PËR MULTIKULTURALIZMIN

RAPORTET E MIRA NDËRETNIKE, SHPËTIM PËR MAQEDONINË

Frenk Janmat, përfaqësues i Delegacionit të BE-së në Maqedoni, thotë se Unioni përmes këtij projekti e ka përforcuar dialogun ndëretnik dhe se drejtpërdrejt e ka mbështetur implementimin e Marrëveshjes së Ohrit



Koha Remzije BILALLI

Shkup, 26 tetor - Inicimi i diskutimit për sfidat momentale në marrëdhëniet ndëretnike në vend, theksimi i përkushtimit politik dhe institucional në zhvillimin e dialogut ndërkulturore dhe ndëretnik pati për qëllim Konferenca kombëtare e titulluar "Drejt multikulturalizmit integruar" që u mbajt dje në Shkup,

në kuadër të projektit "Diversiteti është në modë - Promovimi i multikulturalizmit në nivel lokal".

"Republika e Maqedonisë gjithmonë ka qenë shembull i shkëlqyer se si respektohen etnitë e ndryshme, kulturat dhe religjionet. Sop pas një periudhe të caktuar të gjithë jemi shumë krenarë për ndërtimin e një shoqërie me qytetarë të barabartë, koncepti i cili siguron të ardhme për të gjithë në shtetin tonë", tha deputeti Aleksandar Kiracovski në fjalimin në konferencë. Ajo që

është e rëndësishme, shtoi ai, është që shteti ynë është në një proces inkulturore dhe të kulturave edhe religjioneve, etnive me qëllim që të sigurojmë shoqëri për të gjithë dhe hapëron me guxim drejt BE-së dhe NATO-s. Frenk Janmat, përfaqësues i Delegacionit të BE-së në Maqedoni, thotë se Unioni përmes këtij projekti e ka përforcuar dialogun ndëretnik dhe se drejtpërdrejt e ka mbështetur implementimin e Marrëveshjes së Ohrit.

"Me këtë projekt arritëm disa

qëllime, ndërsa njëri prej tyre është korniza multikulturore për planifikim të cilën mund të shfrytëzojnë vetëqeverisjet lokale", tha ai. Janmat vlerëson se marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni janë të mira edhe pse siç thotë gjithmonë mund të jenë më të mira.

Në konferencë fjalime patën edhe Albert Musliu, drejtor i parë ekzekutiv i Asociacionit për Nisma Demokratike ADI dhe Rubin Zemon, këshilltar i veçantë për zhvillimin e multikulturalizmit në zyrën e Kryetarit të Qeverisë si edhe kryetarët e komunave të Tetovës dhe të Kumanovës, Teuta Arifi dhe Maksim Dimitrievski. "Duke pasur parasysh se vendi ynë është drejtuar drejt proceseve euro-integruese, besoj që gjendja e raportit ndëretnik do të ndikojë pozitivisht, sepse një shoqëri e sigurt do të ndikojë dhe do të rrisë standardet jetësore, ndërsa qytetarët do të kenë mundësi më të vogla për konflikte ose mbështetjeve të situatave të kon-

flikti si dhe retorika ndëretnike", tha Musliu. Kryetari i Kumanovës, Maksim Dimitrievski i shpreh se konflikti ndëretnik është më i theksuar në Komunën e Kumanovës, edhe pse qytetarët në disa raste e dëshmuar se janë drejtë vetëdijesit dhe bashkëjetesës ndëretnike. Ai më tej shtoi se qëllimi i tij është që të bashkojë këto grupe qoftë në kafene, teatro dhe institucione të tjera sepse kjo do të sjellë një jetesë më të mirë.

Në anën tjetër, Teuta Arifi tha se Komuna e Tetovës ka buxhet të veçantë për OJQ-të, të cilët mund të konkurrojnë me projekte për multikulturalizëm, ku janë të kyçur të gjitha gjuhët dhe kulturat, duke krijuar bashkëpunimi më të gjitha bashkësitë fetare, etnike dhe kulturore për të ndërtuar një shoqëri evropiane. Projekti është zbatuar nga Asociacioni për Nisma Demokratike (ADI) Gostivar, me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shkup.

ANALIZË PËR DHUNËN NDAJ GRAVE

PËR TETË VJET, JANË VRARË 70 GRA

“Gratë vriten në shtëpitë e tyre, në shtëpitë ku ata duhet të jenë më të sigurta dhe vriten nga partnerët ose anëtarët e familjes, nga ata që duhet t'i mbrojnë”, tha Dimushevska

Koha Qefser ABDYLI

Shkup, 26 tetor - Në periudhën 2008-2016, në Maqedoni janë vrarë 70 gra, prej të cilave 51 raste kanë arsye për t'u kualifikuar si vrasje femicide, tha Elena Dimushevska, drejtoresha ekzekutive e Rrjetit kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare. Duke iu referuar analizës, Dimushevska theksoi se mbi 80 për qind e grave që janë vrarë në Maqedoni, janë vrarë nga ana e partnerëve intimë, pa marrë parasysh në jetë martesore ose jashtë martesore.

“Gratë vriten në shtëpitë e tyre, në shtëpitë ku ata duhet të jenë më të sigurta dhe vriten nga partnerët ose anëtarët e familjes, nga ata që



duhet t'i mbrojnë”, u shpreh Dimushevska, duke shtuar se numri më i madh i vrasjeve janë kryer me armë, që kryesisht ishin të paligjshme. Në promovimin e publikimit u adresua edhe ministri i Punëve të Brendshme i Maqedonisë, Oliver Spasovski, i cili tha se ky promovim është hapi i parë për të marrë masa në të ardhmen për të zvogëluar dhe për të parandaluar raste të tilla të dhunës në familje.

“Është e qartë se duhet të arrihet në ndryshimet në Kodin Penal të cilat do të përcaktojnë krimin si çështje juridike penale në mënyrë që të lejojë institucionet për të ve-

pruar, por shumë më e rëndësishme është si krijojmë një sistem të parandalimit”, theksoi Spasovski. Ndërkaq, ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska, tha se dhuna ndaj grave në Maqedoni nuk është çështje e një institucioni, por është çështje kombëtare dhe çështje e të gjithë qytetarëve. “Prandaj Qeveria e Maqedonisë në Kuvend menjëherë pas ardhjes së qeverisë e propozoi ratifikimin e Konventës së Stambollit, por nuk ratifikuam vetëm Konventën e Stambollit, por kemi bërë edhe një plan operativ për zbatimin e saj me hapa konkrete dhe masat për çdo

institucion”, tha ministria Carovska.

Koordinatorja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe përfaqësuesja e Programit për Zhvillim të OKB-së në Maqedoni, Louisa Vinton, tha se janë krenarë që kanë mundur mjetet dhe vull për zhvillim të këtij studimi. Femicidi identifikohet globalisht si shkak kryesor i vdekjes së parakohshme të femrave. Nën termin femicid zakonisht kuptohet vrasje me paramendim të gra, por përkufizimet më të gjera përfshijnë të gjitha vrasjet e grave apo vajzave.

Të dielën akrepat kthehen për një orë pas

Shkup, 26 tetor - Natën ndërmjet të shtunës dhe të dielës përfundon llogaritja verore e kohës, duke kthyer akrepat pas për një orë, kur fillon periudha e llogaritjes dimërore të kohës. Të dielën, më 28 tetor, kur akrepat shënojnë orën tre, ato duhet kthyer pas për një orë për të treguar orën dy. Me këtë llogaritje do të vazhdojë edhe sivjet matja e kohës deri në fundjavën e fundit të marsit të vitit 2019, kur rikthehet llogaritja verore e kohës. Komisioni Evropian më 12 shtator të këtij vitit ka marrë vendim që lëvizja e akrepave të orës, kthimi në llogaritjen verore për herë të fundit të bëhet më 31 mars të vitit 2019, ndërsa shfuqizohet në tetor të vitit 2019. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha vendet anëtarë të BE-së. Maqedonia ende nuk ka marrë ndonjë vendim, ndonëse priret që ai të jetë me atë të Bashkimit Evropian.

MINISTRI ADEMI NË KONFERENCËN MINISTRORE NË BEOGRAD

Revizion i kornizës ligjore për arsimin

Beograd, 26 tetor - Ndjekja e rrjedhave globale, trendeve dhe ndryshimeve në arsim, përveç sigurimit të qasjes së barabartë dhe mundësive arsimore për çdo individ, paraqet edhe investim të vazhdueshëm në cilësinë e procesit arsimor përmes të cilat të rinjtë do të fitojnë shkathtësi dhe aftësi, që do t'u përgjigjen kërkesave të iniciuara nga lëvizjet dinamike të tregut të punës. Kështu vlerësoi ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ademi gjatë punimeve të Konferencës Ministrore, që zhvillohet në Beograd të Serbisë, me temën “Vizioni i bashkëpunimit rajonal për formim dhe arsim cilësor”. Republika e Maqedonisë, sikurse plotësoi më tej ai, ka miratuar Strategjinë e arsimit 2018-2025, e cila i përcakton qartë sfidat dhe prioritetet, të cilat do të jenë në fokus të angazhimeve gjatë periudhës në vijim.

Strategjia në fjalë, tha ministri Ademi, garanton standarde më të larta për cilësinë e arsimit, mban parashenjë evropiane dhe presim që në mënyrë të konsiderueshme të kontribuojë në procesin e integritetit të sistemit arsimor të Maqedonisë në hapësirën arsimore evropia-



ne, si dhe do të ndikojnë edhe në rritjen e konkurrencës. “Jemi të vetëdijshëm për nevojën për të përmirësuar efikasitetin e politikave, duke i ndjekur rezultatet nga pjesëmarrja në studimet ndërkombëtare TIMSS dhe PISA. Në këtë drejtim kemi ndërmarrë aktivitetet dhe jemi pjesë e ciklev rezultateve nga pjesëmarrja në studimet ndërkombëtare TIMSS dhe PIRLS”, ka shtuar ai. Ademi i ka njoftuar kolegët nga rajoni edhe për përcaktimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për revizionin sistematik të kornizës ligjore, si rezultat i së cilës muajt e fundit ka pasur aktivitete për ndry-

shimin e disa ligjeve arsimore. “Është hartuar draft/versioni i ri i Ligjit të arsimit fillor, i cili përmban dispozita që nënkuptojnë ndryshime në procesin mësimor, në statusin dhe të drejtat e mësuesve në shkollat fillore, si dhe do të ketë ndryshime në përforcimin e vlerave themelore kushtetuese në procesin arsimor. Ligji do të mundësojë arsim cilësor për nxënësit dhe kushte më të mira për mësuesit”, ka sqaruar ministri duke theksuar se në Maqedoni ka nis zbatimimi edhe një reformë gjithëpërfshirëse e arsimit të mesëm profesional.

Në pranga katër punonjës të Demir Kapisë

Shkup, 26 tetor - Në bazë të padisë penale të ngritur nga Policia Financiare, prokurori publik kompetent nga Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit solli vendim për zbatimin e procedurës hetuese kundër katër personave, shtetas të Maqedonisë për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Në propozimin e prokurorit publik, gjykatësi në procedurë paraprake pranë Gjykatës Themelore Shkupi 1 me vendim tre të dyshuarve iu përcaktoi masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30-të ditëve, ndërsa për të dyshuarin e katërt është përcaktuar masa -arrest shtëpiak. Siç kumtoi Prokuroria Publike, të dyshuarit akuzohen se kanë kryer vepër penale “keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar”. I dyshuari i parë, në cilësinë e organit ekzekutiv të Komunës së Demir Kapisë, i ndihmuar nga i dyshuari i dytë dhe tretë dhe i inxhur nga i dyshuari i katërt në periudhën prej vitit 2013 deri në vitin 2017 e ka keqpërdorur pozitën dhe autorizimin e tij zyrtar, në atë mënyrë që me të dyshuarin e katërt ka lidh marrëveshje për shitjen e një objekti vlerësor të Komunesë së vjetër e rindërtuar e një shkolle dhe tokë në pronësi të Komunës për vlerë dhjetë herë më të vogël se çmimi real i tregut. Gjatë shitjes, siç bëhet e ditur në kumtesë, nuk është marrë parasysh investimi paraprak gjatë rindërtimit të objektit nga Marrëveshja për grante nga Instrumenti për ndihmë para anëtarësimi të BE-së të dedikuar për Maqedoninë. Në këtë mënyrë, i dyshuari i katërt është pajisur me përfitim të paligjshëm pronësor në dëm të buxhetit të Komunës së Demir Kapisë. Në të njëjtën kohë, i dyshuari i parë gjatë vitit 2017 pa kompensim ia ka autorizuar fondacionin, themelues i të cilës ishte Komuna e Demir Kapisë një të afërm të tij, me çka i ka mundësuar që të pajiset me përfitim të paligjshëm pronësor në dëm të Buxhetit të Komunës në vlerë prej 4.208.922 denarë. Me veprimet e ndërmarrta, të dyshuarit e kishin dëmtuar Buxhetin e Maqedonisë në vlerë prej 5.021.000 denarë dhe Buxhetin e Komunës së Demir Kapisë në vlerë prej 10.434.569 denarëve.

Kurbani i “pajtimit”

Nga
Daut DAUTI



"PAJTIMI", FJALA MAGJIKE: Shikoja me shumë mosbesim deklaratat se për ndryshimet kushtetuese “janë siguruar 80 vota”. Ishte ky një gjest i “luftës speciale” politike me nervat e oponencës, pori gabuar. Kështu mendoja dhe ende jam i bindur se disa gjëra që duhet bërë prapa skenës nuk thuhet publikisht (nuk ka transparencë në gjithçka). Sepse, nëse pushteti që mëton të sigurojë përkrahje nga opozita, me këtë lloj paralajmërimit, vetëm mund të rrezikonte sigurimin e votave.

Por doli se një lëvizje taktike e Zaevit kishte hapur terrenin për këtë. Gjithçka në një fjalë të vetme. Pajtimi. Fjalë magjike. Oferta për pajtimin i drejtua VMRO-DPMNE-së, në një cajtnot. O votim për ndryshime kushtetuese, o zgjedhje të parakohshme. Dukej se opozitës i përgjigjej të shkojë në zgjedhje me kapitalin e “dështimit të referendumit”. Këmbëngulja kundër ndryshimeve kushtetuese, në anën tjetër, linte përshtypjen e mbrojtjes së një agjende antiperëndimore.

Pajtimi? Falja? Amnistia? Një ofertë e domosdoshme për situatën e komplikuar, ishte bërë tashmë me një ndërhyrje në gjyqësor (përmes imperativit politik), ende pa u arritur kjo përmes parlamentit. Cilado formë e “pajtimit” që do të bëhet, “pajtimi” kishte qenë “shtytsa” kryesore për 8 deputetët e opozitës (shtatë prej tyre të VMRO-së) për t’u bashkëngjitur shumicës parlamentare. Kjo zaten ishte argumenti kryesor i deklaratave të tyre për ta hequr nga vetvetja dyshimin për “shtjje për pare”, krahas interesit të shtetit për të mos shkarë nga kursi euroatlantik. (Rrezikimin e kursit pro-perëndimor, Sasho Mijallkovi ia adresoi si akuzë liderit të partisë).

Enigma se ç’do të thotë pajtimi

tashmë gjithë opinionin e ka vënë në “mendime”. Qëllimi për ta debllokuar procesin e ndryshimeve kushtetuese në bazë të Marrëveshjes së Prespës, u arrit. Por kjo, padyshim u bë përmes një oferte e cila rrënon shtetin juridik, pasi nuk ka më kurrfarë mëdyshtjesh se nën termin “pajtim” fshihet “falja” nga ndjekja për vepra penale. Këtë një herë e provoi kryetari Ivanov, por hasi në kundërshtim të ndërkombëtarëve dhe të subjekteve që ngjiteshin në pushtet. Por, tash, për shkak të interesit më madhor, me pajtimin, të gjithë do t’i mbyllin sytë. Por, me çfarë përmasash do të jetë falja? A do të shkohet me falje të veprës “terrorizëm” për 27 prillin, që ishte një natë ku u tentua, siç thotë shumëkush, grusht-shteti, apo dhe më gjerë? Çuditërisht, fill pas shënitimit të ditës së VMRO-së, kjo parti u tregua kooperative dhe paralajmëroi se vetë do të propozojë ligjin për 27 prillin, sikur të mos i kishte përjashtuar nga radhët e veta ata që një ditë më parë me votën e tyre ishin “fljuar” pikërisht për këtë!

Por duhet thënë qartë se vetë falja për veprat e 27 prillit 2017, është hap kundërthënës, sepse përveç atyre që e kanë hapur derën e Parlamentit për të hyrë protestuesit (deputetët Mukovski, Vasilevski...), për çka vepra e tyre mund të konsiderohet si një “ndihmë në kryerjen e aktit terrorist”, do të përfitojnë edhe ata që kanë bërë tentim vrasjeje (ndaj Zijadin Selës, Zoran Zaevit, Sheqerinskës...!) U tha me ton ironik nga Mickovski që me amnisti të përfshihen të gjithë aktorët e 27 prillit. Por, kundërthënës do të jetë pikërisht tentimi që falja të kufizohet vetëm në këtë datë. Sepse kjo e ka kleçkën prapa, ngase nuk do të kishte logjikë që të votonte Elizabeta Kançevska – Millovska, ndaj së cilës ka lëndë në

Prokurorinë Speciale për shkak të keqpërdorimit të mjeteve buxhetore për Shkupin 2014. Ajo me asgjë nuk ka gisht në 27 prillin. Pra, nëse në falje do të përfshihej Elizabeta, çka do të bëhet me ata që ndiqen për vepra të ngjashme, ish-shefi i saj, Nikolla Grujevski, ose ministrat Mile Janakievski, Gordana Jankullovska, ose Sasho Mijallkov, i cili tash akuzon Mickovskin për orientim antiperëndimor. A mund të bëhet pajtim pa faljen e “peshqve të mëdhenj”? Në kontekst të kësaj, përgjigjen e jep vota e Elizabeta Kançevskës. Faktori kohë, kësaj radhe është duke punuar pikërisht për peshqit e mëdhenj... Gjithkush luan si në atë lojë e feminjësisë “kukamsheftas”, por gjithkush e di “ku fshihet lepuri”.

PAJTIMTARI SHQIPTAR PËR KOKAT E NXEHTA MAQEDONASE: Është tipike për situatën maqedonase, gjër në ironi. Me vite kanë pasur nevojë që të ndërhyjë dikush për të tejkaluar situatën e caktuara, qoftë nga BE, qoftë nga SHBA. Nga lehtësues gojëmbël gjër të buldozer-diplomatë pa doreza. Situata që kemi tash, është fryt i një ndërmytësimi të tillë. Por, kësaj radhe ironia është paksa më e madhe. Për hir të interesave madhore, lipset edhe një pajtim i radhës! Gjithnjë fjalën e kemi për pajtim të palëve brenda maqedonase, ku ka ndasi serioze si në baza ideologjike, partiake, por dhe identitare!

Po tash si të pajtohen dhe kush ta bëjë këtë? Talat Xhaferit! Kryetari autoritativ dhe karizmatik i Kuvendit të Maqedonisë, e mori rolin e pajtimtarit. Ai do të jetë në krye të komisionit të pajtimtimit, si një ironi fati për subjektet maqedonase, kur një shqiptar hyn ndërmytjet tyre. Por, dhe i shkon një shqiptari që të jetë në rol të tillë. Ne kemi traditë në pajtimin e gjaqeve, që në masë të madhe, të

Largasaj që misioni pajtimtar i Talat Xhaferit të jetë i atyre përmasave të faljes së gjaqeve ndërshqiptarët, sepse tash duhet të falen vepra të bëra si rezultat devijimesh e keqpërdorimesh të pushtetit. Të gjitha mënyrat tjera u provuan, po nuk pati sukses, ka mbetur që kjo, që politika të bëjë kurban shtetin juridik për hir të “interesave madhore”



paktën në trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë, ishin shuar shumë hasmëri viteve 80-të dhe 90-të (në dallim nga Shqipëria, ku viteve 90-të qenë kthyer hasmëritë e vjetra dhe gjakmarrja!). Larg asaj që misioni i Talat Xhaferit të jetë i atyre përmasave, sepse “moduset” e faljes këtu kanë natyrë tejet banale, të falen vepra të bëra si rezultat devijimesh e keqpërdorimesh të pushtetit, por ç’do, qëllim strategjik i dekluar kaheër (integritet euro-atlantike), kërkon kurban. Shkurt e shqip, e politika do ta bëjë kurban shtetin juridik. Të gjitha mënyrat tjera u provuan, po nuk pati sukses, ka mbetur vetëm kjo filjesë.

KUSH KË DO TË “PASTROJË”: Te Hristijan Mickovski, shumëkush mund të shihte një reformator të heshtur të partisë për t’u shkëputur nga gjithë ajo që ishte e mbrapshtë, që qëllimet e vërteta i fsheh në floskula patriotike. Por, gjënë e parë që bëri pasi kaloi ligji për ndryshimet kushtetuese, ishte përjashtimi i atyre që kishin thyer disiplinën partiake. Shkoi shumë lartë, gjër të ish-shefi i Drejtorisë së Sigurimit Shtetëror, Sasho Mijallkov, ish-dorë e djathtë e Nikolla Grujevskit. Përjashtoi nënkryetarin e partisë dhe dy nga ministrat e njohur të qeverisë së kaluar, dhe natyrisht, deputetët që votuan për ndryshime, disa prej të cilëve ishin liuar nga parburgimi. Një nga figurat kyç të garniturës së Grujevskit ishte Ilija Dimovski, ish-coordinator i grupit parlamentar të VMRO-së. Fill pas votimit për ndryshimet kushtetuese dhe hajkës që filloi Hristijan Mickovski, deklaroi se nuk do të marrë pjesë “në situatat e finguar”. Uh, çfarë fjale! “Fingimi” në fjalorin politik të ne ka hyrë si term për “ta sqaruar” gjenezën e konfliktit të 2001-shës. Shumëkush është i bindur se ai ka qenë konflikt “i finguar”.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botes: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bui. Gose Delcev nr.11, | Q.T. Mavrovazja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shlyçi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premta 26 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halli BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirlogaritë: 210063340670177; Tutunsa Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Edhe kundërshtarët e Brankut (Cërvenkovskit) dhe të Ali-së (Ahmetit) e kanë theksuar për vite me radhë fingimin. Një pjellë e fantazisë së bujshme... Po, ta lëmë atë vit, bëjmë fjalë për tetor 2018, dhe bëjmë fjalë për "konflikt", siç e quan shumëkush, "brenda llojit" dhe mos vallë Ilija Dimovski i ka rënë "në trag" se gjithë spastrimi që e bëri Mickovski brenda dy-tri ditësh në radhët e VMRO-së për të dëshmuar unitetin e partisë kundrejt të padëgjueshmëve, s'është gjë tjetër pos një fingim?! Por, në një portret që i pata bërë Mickovskit, e kisha përdorur shprehjen "a thua është edhe ai një 'njeri rasti' në politikë dhe tash më kthehet kjo dilemë, sepse pastrimi i radhëve të partisë më duket një përpjekje e tij për të dëshmuar se nuk është njeri rasti. Shembulli i Gruevskit, i cili shumë shpejtë vuri nën hije ish-liderin (Lubçon), tash mund t'ia ketë rritur oretet Mickovskit që ta lënë nën hije Gruevskin, i cili në të vërtetë edhe e zgjodhi si trashëgimtar të tij, si njeri të besueshëm që do mbrojë shokët nga "përndjekjet politike" të Katicës e Fatimes. Por, enigma më e fundit është nëse garnitura e kaluar i bëri atij puç para se ky të behej lider i mirëfilltë, pasi vota e shtatë deputetëve është siguruar me ndikimin e tyre? Nëse e kishte seriozisht këmbënguljen kundër Marrëveshjes së Prespës dhe ia prishën 7 deputetët, kryesisht nën hetime dhe me dosie gjyqësore, për të grushti që i madh, aq më tepër kur ai vetë e drejtoi gishtin nga ish-numri 2 i (dikush thoshte nr1), Sasho Mijalkov, kurse ai është kushëri i Nikolla Gruevskit, i cili "për shkak të obligimeve" nuk mori pjesë në përvjetorin e themelimit të VMRO-së historike.

E vërteta e hidhur për Mickovskin është se pikërisht rebelimi i shtatë deputetëve, edhe pse kundër politikës së tij "të fortë" kundër ndryshimit të emrit, praktikisht ata e kryen misionin që duhej ta kryente ai. Konflikti i tij me ish-at, është pak si i çuditshëm, sepse një gjë e tillë, nëse nuk është finguar, është një sfidë serioze për të. Ai, masën e spastrimit, e shoqëroi me fjalën "pastrimi nga elementet kriminale" të partisë! Është një gafë sepse ai kështu haptas pranon që në VMRO ka këso elementesh, edhe pse deri sot fliste se gjykimet ndaj tyre janë politike! Nëse nuk është situatë e finguar, siç mund të pretendojë Ilija Dimovski, atëherë Mickovski mund ta pastrojë përnjëmend partinë nga ato elemente, nëse kërkon amnistinë vetëm për 27 prillin, me çka do t'i çojë në burg si Gruevskin, Jankullovsken, Janakievskin, madje edhe Sashon. Por, duke dashur të mbrojë vetullat, mund t'i qesë sytë, sepse pastrimi i radhëve ose madje dhe reformimi i partisë mund të ngecë në gjysmë, pasi rreshtimi i tij kundrejt marrëveshjes për emrin e hodhi përballë gjithë bashkësisë ndërkombëtare, ndërsa që të është e vështirë të mbijetojë ndonjë politikan që i bën karshillëk Evropës ose Amerikës. Në anën tjetër, përpjekja për t'i larguar figurat kyç të partisë, nuk mund të bëhet pa përcarje të mëdha dhe pasoja për të. Prandaj, gjithë këto ndodhi në VMRO mund të jenë një episod kalimtar gjer te reformimi i vërtetë, sepse reformimi me njerëz me frymë të vjetër, nuk mund të ketë. Aq më tepër, nëse përballë përnjëmend i ka figurat të cilat deri dje i mbanin frerët jo vetëm në parti por dhe në shtet.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Politika makiaveliste

Nga
Dr. Arben TARAVARI



Nikola Makiaveli do të shkruante e botonte një vepër të cilin e quante "Princi". Në vitin e largët 1532 libri do të botohej me lejen e Papa Klementit të VII, megjithëse ishte lexuar si dorëshkrim para se të njihje dritën e botimit. Kishte shkaktuar jo pak zhurmë në shoqërinë e asaj kohe që sapo kishte hyrë në epokën e përndritjes. 5 vjet pas vdekjes së Makiavelit libri do të klasifikohet si hapi i parë drejt asaj që më vonë u pagëzua si Filozofia Madere.

Kjo vepër i dedikohet sundimtarit të atëherëshëm të Firences, Lorenzo di Peiro de Medeci, i cili i përkiste dinastisë së familjes Medici, dinasti e cila ishte kundër veprimtarisë dhe vizionit të teoricentit politik Makiaveli. Në qendër të këtij libri është në fokus sjellja dhe mënyra e një sundimtari që mund të jetë një princ, president, kryeministër, kryetar Komune apo kryetar partie. Sipas Makiavelit populli duhet të marrë të mirëqenë dhe si kreytë të natyrshme, që një udhëheqës duhet të bëjë gjithçka për të mbajtur pushtetin e tij. Është e famshme thënia e tij: më mirë të kenë frikë se sa të të duan.

Sipas autorit natyra njerëzore është e paqëndrueshme, është lakmitare dhe shumë më e bindur ndaj atij që ja ka frikën se sa ndaj ndonjë njeriu që e lidh vetëm respekti dhe dashuria. Libri krijoi shumë polemikë, vetë Vatikani e klasifikoi në librat e ndaluar. Nga subjekti i këtij traktati doli dhe termi "makiavelist" që nënkupton dinakëri dhe dyfytërsi në artin e qeverisjes apo në çfarë do lloj pozite drejtuese.

Ka shumë teoricien e politologë që Makiavelin e kanë cilësuar si një gjeni të asaj që quhet Politikë Moderne, duke e shpallur libërthrin e tij si një nga satirat më të mëdha të veprave politike të shkruara ndonjëherë. Dhe e famshmja Realpolitika që thërret për pragmatizëm shpesh herë barazohet me makiavelizmin. Pra, sundo me çfarë do lloj çmimi, bëj edhe keq duke shkëlur çdo normë morali apo kod pari-



Atë që shqetësohet vetëm për interesa personale të ngushtë, që shkel çdo etikë morale, çdo kod nderi, që vjedh, vret e pret për të pasur pushtetin e siguruar, që këtë të fundit e sheh si mjet për t'u pasuruar e për të kontrolluar jetën e ne të tjerëve, admiruesve të Padronëve, të shefave të Pamoralshtëm që shesin Moral dhe ne ja blejmë, me jetën tonë, me jetën e fëmijëve tanë dhe i duartrokasim!

mor sepse për një udhëheqës të shëndoshë "qëllimi justifikon çfarë do lloj mjeti". Tani le të vijmë nga Firenca e 1532-it në Maqedoninë e 2018-ës.

A kemi ne politikan makiavelistë apo kemi një prire më të justifikuar drejt Realpolitikës apo kemi politika socialiste, demokratike apo qoftë edhe kapitaliste deri tek komuniste?! Rymat politike janë pak a shumë si librat e shenjta që aq shumë sa besimtarët kanë konflikte me njëri-tjetrin aq shumë ideologjitë e tyre ngajjnë. Çfarë jemi ne të prirur të krijojmë me llojin e politikantit që promovojnë dhe natyrisht vetpromovohet? Mos ndoshta jemi ne një popull që krijojmë dhe mbrojmë figurën e politikantit makiavelist?

Shembulli është i thjeshtë: Nëse marrim vesh që në lagjen tonë ose vendin e punës dikush ka vjedhur 100 euro e shpallim hajdut, e marrim inat, e shmangim nga rrethi ynë shoqëror, paralajmërojmë

të gjithë ata që i duam të kenë kujdes nga "hajduti" dhe e marrim si shembull të së keqes duke pasur frikë dhe urrejtje ndaj tij. Ndërkohë që situata është kreyt ndryshe nëse vjedhja bëhet nga ndonjë politikan, i cili punon në ndonjë funksion ku mund të grabisë qindra e mijëra euro.


Ai nuk është hajdut për ne! Ai është thjesht Politikan! Duket se jo vetëm është i arsyetur në grabitjen e tij, por edhe gati i admiruar nëpërmjet dëshirës gati patologjike që kemi për të pasur miqësi me pushtetarët ose me "shefat". Amnistia që shfaqim përballë krimit dhe korrupsionit politik është e pashpjegueshme. Glorifikimi që i bëjmë këtyre individëve edhe pse janë shumë larg moralit dhe parimeve mbi të cilat duam të edukojmë fëmijët tanë, është kaq i madh, sa ndonjëherë kthehet në një proces të denjë për analizë profesionale psikologjike. Çfarë na shtyn të admirojmë me votën tonë "Politikanin e Ploftuqishëm", "Babën", "Bacën", "Shefin"...

Çfarë është kjo dakordësi zyrtare dhe e vetëdijshme me paudhësitë morale dhe parimore të politikanëve?! Mos jemi ende shumë të ndjeshëm dhe të pamësuar për t'u përballur me atë që e quajmë Shtet të Drejtë, Shtet të Lirë, Shtet të Demokracisë?! Mos ndoshta jemi një grumbull dembelash që na pëlqen të rrisim fëmijët tanë në një ambient të minuar duke mbështetur pasurimin e shpejtë nëpërmjet korrupsionit? Një gjë është e sigurt, ne përligjimin politikën makiaveliste.


Atë që shqetësohet vetëm për interesa personale të ngushtë, që shkel çdo etikë morale, çdo kod nderi, që vjedh, vret e pret për të pasur pushtetin e siguruar, që këtë të fundit e sheh si mjet për t'u pasuruar e për të kontrolluar jetën e ne të tjerëve, admiruesve të Padronëve, të shefave të Pamoralshëm që shesin Moral dhe ne ja blejmë, me jetën tonë, me jetën e fëmijëve tanë dhe i duartrokasim!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)





FJALËKRYQI KLASIK



HORIZONTALISHT:

3. Çarçaf dyshekësh (bised.); 5. Qytet në Francë; 7. I marrë, i çmendur; 9. Komisioni vlerësues; 10. Mal në Shqipëri; 12. Bixhoz; 13. Ish presidenti shqiptar, Alia; 15. Zog i vogël; 16. Vozitës; 18. Baba; 20. Monedha ruse; 23. Një lidhëz; **24. Emri i mezzosopranos sonë në foto; 26. Mbiemri i këngëtares në foto;** 28. Ndez; 29. Banore e Beotisë; 30. Grusht shteti; 31. Shtiza e parmendës; 33. Degë e psikologjisë; 41. Shapka; 42. Këshilltar ligjor juridik (sh. pashq.); 43. Mëzat, ka; 44. Përgatit, gatuaj; 47. Politikani finlandez, Ren; 48. Idhuj; 49. Verore, erashkë.



VERTIKALISHT:

1. Dhunë ndaj një populli; 2. Trashëgimi (bised.); 3. Në sasi të vogël; 4. Këngëtarja jonë, Eli; 5. Rrjedhë uji; 6. "Mbreti" i Shekspirit; 8. Posedoj; 9. Një anë e botës; 11. Kafshë e egër; 12. Lloj zogu (i zi); 14. Zona Operative; 15. Sunduesi i qiellit dhe tokës të grekët e lashtë; 17. Qytet në Kanada; 18. Liman në Er-itre; 19. Ana e mprehtë e shpatës (sh. pashq.); 21. Pjesë e harkut; 22. Njeri që i shmanget punës, hileqar; 24. Klub i Seviljës; 25. I ngjyrës së kuqe të ndezur; 27. Moskryerja e pagimit; 30. Ish futbollisti gjerman, Sep; 32. Inicialet e shkrintarit, Keko; 33. Partia e Aksionit Demokratik; 34. Shpallje; 35. Bakër; 36. Alumini; 37. Ujë (frëngj.); 38. Trajneri kroat, Bariq; 39. Këndezi; 40. I moshës së re; 45. Këngëtar i anglez, Ant; 46. Bar.

Kakuro

5x5 dhe 6x6


Kakuroja është kombinim i fjalëkryqit dhe Sudokut. Në vend të shkronjave shënohen numra edhe atë prej 1 deri 9. Numrat nuk duhet të përsëriten as horizontalisht e as vertikalisht. Numrat brenda fushave duhet t'i japin shumat, të cilat janë dhënë në skajet e fushave që duhet të plotësohen.





DOMINOJA

Plotësoni fjalëkryqin duke i bartur katrorët e dhëna më poshtë. Në fushat e hijëzuara do të fitoni emrin e përrallës në fotografi.



O	M	P
G		A
R	A	T

R	T	E
I	A	
O	L	E

A	J	A	M	I	K	Z	A		T	A	M	S	H	K	U	D	A		I	K
F		L		K	U		D	A	E	L	I	P	A	R	O	R	I	O	R	
I	K	O	A	S		M	O	L		T	R	R	I	G	K	I	P	S	E	

E	N	S	F	E	J	I	R	I	U	A	R	A	L	F	E	N	U	B	L	E
Z	I	A	O	R	A	S	H	A	T	T		D	L	O	J	S	I	S	E	E
O	S	T	T	O		A	R	E	E	N	I	Z	O	A	J	R	T	V		

Fshehësira

Ku fshehen 19 figurat e dhëna?



DALLIMET

Gjejini 5 dallimet!



DEKODIMI

Lidhni pikat e zeza, duke filluar nga katrori i vogël dhe përfundoni te rrethi. Në fushat e pikave të zeza duhet të zgjidhni njërën nga katër shkronjat e dhëna dhe të vazhdoni në fushën tjetër. Në fund, lexuar me radhë do të fitoni zgjidhjen e gjëgjzës:

*"Majën nën thikë
fillon të hollohet,
shënon vizë-pikë,
por ngadalë shkurtohet."*

ABÇ	DDhEË	FGGjH
IJKL	LIMNNj	OPQR
RrSShT	ThUVX	XhYZzh

Zgjidhja: L A P S I


Mini SUDOKU

Në kutizat e dhëna duhet t'i shënoni numrat prej 1 deri 4. Tabelën do ta plotësoni duke i shënuar këto numra në fushat e zbrazëta, por me kusht që ato të mos përsëriten.

1	4	3	2
3		1	4
	1		
2			

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".




KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.




ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!



NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.



mini SKANDI me anagrame

Më poshtë janë dhënë anagramet e dy filmave të regjisorit të tonë në foto.

Film 1

AROMË FEMRE

Anagrami 2

PËRULËN TËRË MILETIN

(N=K)

MENSUR MAMUTI	REGJISORI PEJAN NE FOTO	PJESËT E NËNË MATERIALI TË SHKRUAR	REVOLUCIONARI JAPONËZ, HROBUMI	FRONTAL ANAGRAMI 2 (FILM I REGJISORIT NE FOTO, "LIRI")	B
PRËSI I HUNËVE					
PJESË E FITYES MB SY					
ISH POLITIKANI ZIMBABVEAN, XHOSHLA					
LIRIANA SULKULI			E. R.		
ANAGRAMI 1 (FILMI TË REGJISORIT NE FOTO)			EMERGJIA		
THARTIRË NËNËS (TURQ)	TH	MAT GATËSËNE E TRUPIT LITRI			KAFISË GRABITORE KUNADHE (SH)
T				NOREK, SHKËZ, JERUSALEM	
RUMANA		JO FAKTËRË FATI OYTET NË SUEDI			
POLITIKANI SIRIAN, AL MASRA				LUMË NË RUSI MIKO KANVAHERI	
KOHA E LIRË	NËNA DHE BABAI BANORE E LOKUT (KROACI)				
EMIRI HERIOT BOLETIN			GRACKË ZOTI ERRESHËRËS TË GRACKËT ELASHTË		
DAPËNË (SH. PASHQI) NGJYRA				GRUP MIZIKOR ISLANDEZ, PERSIA	
K				E. T. HYANËSHË SEMTE	
APRATËT EXHIBIT					THAJ
AUSTRIA		LËNË E FORTË PLASTIKË, EBANIT (SH) SHKO			
NDALFOLIE SASIE			LUMË NË BOSNIJE DHE KROACI ZERO		SPANJA LIRIUGJAJI
E KORRUR ME KOSE					

Sudoku

i lehtë

5	4	2				7	9
9	3		6			4	2
		2	5	7	4		
		5	9	6	7		
			3	8			
8	9		1		5	4	
2	5			9	8	1	

mesatar

				2		7	8	4
		9	3					6
			5			1	3	
5			3		4	6		
			7	4				
	6							
1				3				
3	5			2	9			

i vështirë

5			7	8				6
	4		6					1
		6	2			3		
8	7						6	3
4								5
		8			7	2		
	3				5	7		
7		8	4					9

2				4		1	8
		3					
	1					2	3
	8	7	4		1		6
				3			
	5		8		7	9	3
						7	
5		4				6	
7	8			2			9

8			7	2	4	1	
			1			7	8
				4	5	2	
		1	2		9	5	
		7	6	3			
7			2				
3	8						
9	3	6				2	

6								9
	7		3					8
8	5	2			4			1
		7		1				
3			4					5
	9	6		5	8			
2	7	1			9			8
	8	4				2		
1								6

ARITMOGRIFI

Përgjigjet i shënoni në rrjetin me numra (mbi foto). Pastaj, sipas rregullit "numri i njëjtë - shkronja e njëjtë", shkronjat e fituara bartni në tabelën tjetër (nën foto).

Me plotësimin e drejtë të tabelës do të fitoni grupin kosovar (në foto), emrat e anëtarëve të grupit dhe dy hite të tyre.

VERTIKALISHT:

1. Bimë barishtore me erë të këndshme;
2. I dobësuar, i pagjak;
3. Pranimi zyrtarë të një plani;
4. Këngëtari kosovar, Pallaska;
5. Botim periodik i një institucioni;
6. Nim;
7. Katërkëndësh që ka dy brinjë të kundërta paralele dhe jo të barabarta;
8. Stomak;
9. Mallkoj, nëm (bised.);
10. Aktori amerikan, Shon;
11. I ati i babait ose i nënës;
12. Ish solisiti i grupit "Teleks", Ahmeti;
13. Kontrollim i dijes me shkrim;
14. Qese xhepi, për mbajtjen e të hollave dhe karteleve (shq.);
15. Puna e ndërtimitarit;
16. Pjesë artificiale e trupit (dorë, këmbë, dhëmb etj.);
17. Njehsimi;
18. Brezi.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36
37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54
55	56	57	58	59	60	61	62				63	64	65	66	67	68	69
70	71	72	73	74	75	76					77	78	79	80	81	82	83
84	85	86	87	88	89	90						91	92	93	94	95	96
97	98	99	100	101										102	103	104	105
106	107	108														109	110

**LE
GJEN
DAT
e muzikës shqipe**



	11	35	89	102	68	72		6	78	56	69	46	14	27	41	58	65	15	60	108		7	19	53	97	20
85	32	37	12	98	3	84	95	23		8	81	106	109	45	100	29	50	43		30	59	80	83	24	64	107
2	94	110		71	49	104	31	42	33	52	18	70	63	93		4	96	90	99	75	17	77	13	26	40	1
92	74	21		87	67	82	76	9	16	38	66	10	36	39	73	55	25	48	101		79	103	47	105	34	86
44	51	91	5	88	62	22	54	57	61																	

ARITMOGRIFI

DALLIMET

PSHËHSIRA

DOMINOJA

NONOGRAMI

KËNKËN

ARUKONE

SUDOKU

SUDOKU

SUDOKU

SUDOKU

MINI SUDOKU

DEKODIMI

KAKURO

FJALËKRYQI KLASIK

me anagramë

mni SKANDI

ARHOMË PËRREJ

BEOBLENËNË

COOPER: KORRIGJIMI I KUFIJVENUK DUHET TË PËRJASHTOHET NGA BISEDIMET

Nëse Presidenti serb Aleksandar Vuçiq dhe Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi do të dalin me një marrëveshje të mundshme, përpara se të zbatohet atë, ata duhet të sigurojnë bashkësinë ndërkombëtare se i kanë menduar implikimet për rajonin



Ish-ndërmjetësi i BE-së, Robert Cooper, thotë se shkëmbimet e teritorëve nuk duhet të përjashtohen në kërkimin e një marrëveshjeje përfundimtare, duke paralajmëruar se bisedimet "nuk janë ende mjaft të detajuara". Serbia dhe Kosova duhet të vazhdojnë në përpjekjet e tyre për të arritur një zgjidhje, ndoshta duke përfshirë edhe shkëmbimet territoriale, pavarësisht nga reagimi ndërkombëtar, tha për BIRN, ish-ndërmjetësi britanik në dialogun Beograd-Prishtinë, Robert Cooper.

ciat teknike midis dy palëve që nga fillimi i tyre në 2011 deri në 2012, tha se të dy vendet duhet të vazhdojnë në përpjekjet e tyre për të arritur një marrëveshje përfundimtare, duke pasur parasysh pasojat për rajonin. "Unë mendoj se nëse ia vlen të bëjmë, atëherë vlen të këmbëngulësh kundër reagimit ndërkombëtar. Në njëfarë mënyre, kjo tregon se jeni seriozë", tha për BIRN, Cooper, i cili tani është anëtar i Këshillit European për Marrëdhëniet me Jashtë.

Ai shtoi se nëse Presidenti serb Aleksandar Vuçiq dhe Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi do të dalin me një marrëveshje të mundshme, përpara se të zbatohet atë, ata duhet të sigurojnë bashkësinë ndërkombëtare se i kanë menduar implikimet për rajonin.

"Njerëz të ndryshëm kanë mendime të ndryshme. Nga ana ime, nuk e kuptoj pse ekziston një analogji me Bosnjën. Nëse udhëheqja boshnjake ranë dakord për diçka dhe thanë 'Ne duam të ndërshojmë kufijtë', mendoj se BE-ja do të jetë e kënaqur", tha ai.

"Por kufijtë janë gjithmonë të ndjeshëm dhe duhet të jeni të kujdesshëm. Nuk mjafton vetëm që udhëheqësit të bien dakord. Njerëzit më të interesuar—ata që jetojnë atje—duhet të konsultohen gjithashtu", shtoi Cooper, i cili ka mbështetur perspektivën shkëmbim të territorit mes Kosovës dhe Serbisë. Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia në vitin 2008 por Beogradi ka thënë se kurrë nuk do ta njohë pavarësinë e saj. Megjithatë, një parakusht për suksesin e ofertës së Serbisë në anëtarësimin në BE është normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën. Udhëheqja e Serbisë, duke përfshirë presidentin Vuçiq, mendohet të jetë duke konsideruar një shkëmbim territorial si një mënyrë për të zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen dhe kështu të ecë përpara me aspiratën e Serbisë për anëtarësimin në BE.

Ideja është përballur me mosmarrëveshje nga opozita serbe, nga shumë serbë dhe shqiptarë të Kosovës dhe nga disa vende të BE-së, siç është Gjermania.

Sidoqoftë, këshilltari i Sigurisë Kombëtare i Presidentit të SHBA, Donald Trump, John Bolton, tha në gusht se Uashingtoni nuk do të kundërshtonte domosdoshmërisht një shkëmbim territorial nëse Serbia dhe Kosova janë dakord për të.



Kotzias: Shqipërisë i marrim 12 milje det

Ish-ministri i Jashtëm grek Nikos Kotzias, tashmë i çliruar nga përgjegjësitë diplomatike ka zbuluar të tjera detaje nga negociatat për marrëveshjen e detit me Shqipërinë dhe pozicionimin e Greqisë për të shtrirë sovranitetin e saj në 12 milje detare në Detin Jon.

Duke iu referuar zonës bregdetare nga Veriu i Korfuzit deri në Antikythera, Kotzias thotë se me shpalljen e 12 miljeve det territorial Greqia fiton një hapësirë detare të barabartë me sipërfaqen e krahinës së Thesalisë, kjo që shihni në këtë hartë.

'Nga momenti që kanë nisur negociatat me Shqipërinë për vijën bregdetare në diskutim është vetëm një pjesë e vogël. Pjesët e tjera i takojnë Zonave Ekskluzive Ekonomike, pasi Shqipëria e ka bërë shtrirjen e saj në 12 milje në këtë zonë. Dua të bëj një qartësim, nuk kemi krijuar vetëm vijën bregdetare.

Para kësaj kemi bërë dy gjëra. Mbyllëm gjirret dhe mbyllja e gjireve do të thotë se vija bregdetare nis pas vijës bazë, prandaj thashë që nga matjet në kilometra katrorë është një sipërfaqe sa Thesalia që ne fitojmë nga Korfuzi deri në Antykithera.'

Kotzias thotë se mori aprovimin e kryeministrit grek Tsipras për të deklaruar në konferencën për shtyp të pak ditëve më parë miratimin së shpejti të tre dekreteve presidenciale për zgjerimin e ujërave territoriale në 12 milje. Ish-ministri i Jashtëm pranon se parimi i 12 miljeve do të aplikohet edhe në Egje, gjë që kundërshtohet fort nga Turqia.

'Plani është që të ketë vazhdimësi. Kishim një të marrëveshje me kryeministrin, por unë tani nuk jam pjesë e qeverisë dhe nuk mund të marr vendime për llogaritë të Ministrisë së Jashtëm.' Ankaraja reagon menjëherë ashpër përmes ministrit të Jashtëm Çavusoglu, i cili tha se 12 miljet detare janë një 'Casus Belli' për luftë mes dy vendeve. Në të njëjtën linjë është shprehur sot edhe ministri turk i Mbrojtjes, i cili tha se Turqia nuk do të tolerojë asnjë veprim të Greqisë në Mesdheun lindor shkruan Tv Klan.



Daçiq: Ne nuk e japim Kosovën për "karrota" të BE-së

Serbia nuk do të shkelë Kustetutën duke pranuar shtetin e rremë të Kosovës për disa karrota evropiane. Kështu ka deklaruar për "Veçernje Novosti" ministri i jashtëm serb, Ivica Daçiq, transmeton Klan Kosova.

Duke komentuar deklaratën e deputetit të Bundestagut, Peter Beyer dhënë në Klan Kosova "se Serbia s'ka shans të futet në Bashkimin European nëse nuk e njih Kosovën si shtet të pavarur", kryediplomati serb tha se nuk të merret seriozisht se ai vjen nga partia CDU e kancelares Angela Merkel.

Deputeti gjerman i cili vjen nga radhët e partisë CDU të Kancelares Angela Merkel, zhvilloi ditë më parë një vizitë disaditore në Kosovë ku dhe u takua me strukturat udhëheqëse të shtetit të Kosovës./klankosova.tv/.

Ambasadori britanik: Vëllërit e politikanëve në Kosovë, më të pasur se vetë ata

Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruari O'Connell, ka thënë të enjten se Kosova duhet të ndërmarrë reforma të thella për të krijuar një sistem të drejtësisë kredibil dhe me figura të pastra.

"Ne dhe Kosova kemi interesin e përbashkët që këtu të ketë një sistem të drejtësisë efikase dhe të pastër. Kosova të jetë partner i plotë i yni në luftimin e krimit të organizuar. Pas përfundimit të misionit të EULEX-it, Kosova e ka një rast të mirë që të dëshmojë se është e gatshme të marrë përgjegjësi në luftimin e krimeve të rënda dhe korrupsionit", ka thënë ambasadori britanik në RTK, gjatë një debati mbi nevojën që Kosova të zhvillojë një proces të "vetting"-ut në sistemin e drejtësisë.

Ai ka theksuar se është evidente që Kosova ka nevojë për pastrim të sistemit të drejtësisë. Ka marrë

shembull pozitën e tij si ambasador i Britanisë së Madhe për të cilën zhvillohet procedura verifikimi.

"Unë si shërbyes civil duhet të kaloj veting në shërbimin tim çdo 5 vite. Nëse flasim për Kosovë do të ishte shumë e rëndësishme që të krijohet një sistem që vazhdimisht siguron integritetin e sistemit. Tek ne përveç zyrtarëve kontrollohen edhe familjarët e tyre. Kam dëgjuar sa herë në Kosovë që politikanët nuk janë të pasur, por vëllezërit e tyre kanë pasuri. Për mua për shembull kontrollohen edhe qikat e djajës", ka thënë O'Connell.

Ai ka folur edhe për problemin e nepotizmit në Kosovë për të cilin ka thënë se Britania e Madhe po anagazhohet ta eliminojë.

"Problemi i nepotizmit është një problem gjithandej në Kosovë dhe këtë duhet pranuar që është problem dhe duhet të trajtohet.



Përmes memorandumit me institucionet e Kosovës po bëjmë përpjekje që në disa pozita të larta të eliminojmë ndikimet e mundshme. Por ka pas disa procedura ku rekomandimet e kompanisë që është paguar nga Britania e Madhe janë injoruar në tërësi vetëm për të pranuar në pozita udhëheqëse njerëz me të njohshëm", ka thënë ambasadori britanik.

"Novosti" frikëson serbët: Ja plani i KFOR-it dhe shqiptarëve



Gazeta serbe "Veçernje novosti" shkon tepër larg, duke i frikësuar serbët dhe duke krijuar urrejte për shqiptarët te ta.

Siç shihet nga ballina e saj, kjo gazetë në numrin e së enjtes kryetëm ka tekstin me mbittull "Plan

i KFOR-it e i shqiptarëve" e titull "Ushtrojnë goditjen në tanket serbe". Dy nëntitujt janë: "Përgatiten për opsionin e ndërhyrjes së trupave tona në Kosovë" dhe "Aksionin e udhëheqin amerikanët nga baza Bondsteel".

DJALI I KHASHOGGIT KA LËSHUAR ARABINË SAUDITE, SHKON NË SHBA

Sekretari amerikan, Mike Pompeo, ka diskutuar rastin e djalit të Khashoggit, Salah Khashoggi, gjatë vizitës së tij në Arabinë Saudite, duke "ia bërë të qartë" udhëheqësve sauditë se Uashingtoni dëshiron që djalit të kthehej në Shtetet e Bashkuara



Djali i gazetarit të vrarë, Jamal Khashoggi, ka lëshuar Arabinë Saudite pasi mbretëria ka anuluar ndalim udhëtimit dhe e lejoi atë të shkonte në Shtetet e Bashkuara. Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Robert Palladino tha se Uashingtoni e mirëpriti vendimin.

Kjo është e fundit në sagën e shkrimtarit të vrarë saudit pasi Mbretëria të enjten tregoi prova se vrasja ka qenë me paramendim duke ndryshuar historinë sërish duke tentuar që të qetësojë zemërimin ndërkombëtar për vrasjen e tij më dy tetor në konsullatën saudite në Stamboll, raporton AP.

Sekretari amerikan, Mike Pompeo, ka diskutuar rastin e djalit të Khashoggit, Salah Khashoggi,

gjatë vizitës së tij në Arabinë Saudite, duke "ia bërë të qartë" udhëheqësve sauditë se Uashingtoni dëshiron që djalit të kthehej në Shtetet e Bashkuara.

Ndërkohë, bëhhet e ditur se Mbreti i Arabisë Saudite mund të zëvendësojë djalin e tij princin e kurorës për të kthyer besueshmërinë në monarki, pas tensionit të shkakuar nga vrasja e gazetarit Jamal Khashoggi. Këtë gjë e pretendon ish atashu britanik i mbrojtjes në mbretëri. Princi i kurorës Mohammed bin Salman është përballur me pretendimet se mund të jetë prapa vdekjes së gazetarit i cili është zhdukur pasi hyri në konsullatën saudite në Stamboll. Arabia Saudite ka mohuar rolin në zh-

dukjen e Khashoggit para se të fajësohte vdekjen e tij tek përpjekja për ta kthyer në mbretëri atë. Ndërsa Princi i Kurorës lufton për të përmbajtur pasojat nga vrasja, prokurorët e Arabisë Saudite thanë se vrasja ishte e planifikuar paraprakisht dhe të dyshuarit ishin duke u marrë në pyetje. Sipas kolonelit Brian Lees, dikur atashu i mbrojtjes i Mbretërisë së Bashkuar në Arabinë Saudite dhe Jemen, ditët e princit të kurorës si sundues de facto janë të numëruar dhe se babai i tij Mbreti Salman, tani mund të kërkojë ta zëvendësojë atë pas trajtimit katastrofal të rastit. "Sauditët asnjëherë nuk do ta pranojnë që MbS ishte fajtor, por kjo nuk do të thotë se ai është i pa-

stër. Besoj që mbreti, duke marrë parasysh kur është koha duhur, ai do ta heqë MbS duke e zëvendësuar. "Ai nuk mund ta bëjë menjëherë këtë, apo në muajt në vazhdim, sepse kjo do të duket si përkulje ndaj presionit të jashtëm. Ai mund të përdorë mjetin e vendosur të këshillit të veçantë të këshilltarëve brenda familjes për të emëruar një pasardhës. Kjo pa dyshim do të rikthejë besimin në monarki", u shpreh ish atashu.

Presidenti amerikan Donald Trump, në komentet e tij më të ashpër mbi këtë rast, tha se Princi i Kurorës mbante përgjegjësinë përfundimtare për operacionin që çoi në vrasjen e gazetarit, duke rritur presionin ndaj aleatit të tij



Putin: Do të ndërtojë armë të pakrahasueshme me asnjë vend të botë

Presidenti rus Vladimir Putin ka deklaruar se vendi i tij do të ndërtojë armë me fuqi të pakrahasueshme me asnjë vend të botës. Putini ka folur pas një vendimi të Shteteve të Bashkuara për t'u tërhequr nga traktati prej disa dekadash i armëve bërthamore. Gjatë një takimi me zyrtarët e lartë ushtarake dhe të zbatimit të ligjit të enjten ai u shpreh se: Rusia nuk kërcënon askënd dhe ka respektuar rreptësisht detyrimet e saj në sferën e sigurisë ndërkombëtare dhe kontrollit të armëve. Armët aktuale të Rusisë do të modernizohen për t'u mbrojtur kundër kërcënimeve të mundshme, është shprehur Putin.

Mirëpo Putini ka folur në të njëjtën ditë kur 55,000 trupa të NATO-s në Norvegji filluan manovrat më të mëdha ushtarake që nga Lufta e Ftohtë.

Veçse rritja ushtarake e Rusisë në kufirin e saj evropian ka qenë prej kohësh një burim tensionesh prej vendet fqinje, të cilat janë të kujdesshme ndaj inkursioneve ruse si ato në Ukrainë dhe Gjeorgji.



Bolton i dorëzon Putinit ftesën e Trumpit për të vizituar Uashingtonin

Këshilltari për siguri kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, John Bolton, tha se i ka dorëzuar presidentit rus, Vladimir Putin, një ftesë nga presidenti amerikan, Donald Trump, për të vizituar Uashingtonin në vitin 2019.

Në një intervistë për shërbimin armen të Radios Evropa e Lirë, Bolton tha se dorëzoi ftesën gjatë takimeve të tij me Putinin në Moskë, këtë javë. Vizita e Boltonit në Rusi u dominua nga njoftimi se administrata e Trumpit planifikon të tërhiqet nga Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme, i vitit 1987. Kjo marrëveshje, e cila e eliminoi një klasë të tërë të raketave nga Evropa, konsiderohet kyçe për stabilitetin strategjik mes Uashingtonit dhe Moskës. Por, takimet përfshinë edhe çështje të tjera, si luftërat në Siri dhe Ukrainë, ndërhyrja e supozuar e Rusisë në zgjedhjet në SHBA dhe Koreja e Veriut. Trump dhe Putin u takuan për herë të fundit në muajin korrik, në Helsinki./rel

Rezoluta e PE: Jo grupeve neofashiste në Bashkimin Evropian

Parlamenti Europian bën thirrje për ndalimin e grupeve neofashiste dhe neonaziste në BE, theksuan burime pranë tij.

Me një rezolutë jolegjislative, që u miratua me 355 vota pro, 90 kundër dhe 39 abstenime, deputetët e PE u bëjnë thirrje autoriteteve kombëtare të ndalojnë formimin e grupeve të lartpërmendura dhe të çdo shoqate tjetër që glorifikon nazizmin dhe fashizmin si dhe ksenofobinë.

Teksti i miratuar kujtoi mes të tjerash



sulmin që që shkaktoi 77 viktima në Norvegji në vitin 2011 nga Breivik, vrasjen e

deputetes britanike Jo Cox në 2016 si dhe sulmin i fundit fashist nga Casa Pound kundër deputetes evropiane Eleonora Forenza.

Theksohet gjithashtu mungesa e ashpërsisë për neofashistët në disa shtete, marrëveshja e dyshuar midis politikanëve dhe policisë me neofashistët dhe neonazistët si edhe zbatimin e masave të nevojshme kundër racizmit dhe ksenofobisë në stadiumet e futbollit.

Konferencë ndërkombëtare mbi dhunën sociale

Nga data 16 nëntor, e premte e deri më 17 nëntor, e shtunë, në Universitetin e Lozanës do të mbahet konferenca ndërkombëtare, me temën: Dhuna shoqërore, dhuna në masë. Kjo konferencë është organizuar nga ekipi i Muriel Katz në bashkëpunim me Manon Bourguignon, Giuseppe Lo Piccolo & Anaïs Coullery, LARPsyDIS, Rjeti Ndërkombëtar i Kërkimeve "grupi, transmetimi dhe dhuna në masë", Laboratori i Kërkimeve në Psikologjinë e Dinamikës Ndër-dhe Ndër-subjektive (LARPsyDIS), përcjell albinfo.ch.

Në të do të jepet një pasqyrë e ngjarje-

ve nga shekulli i kaluar, urrejtja midisi grupeve të njerëzve që u përshkallëzuan në gjenocidi, shpërngulje të detyruar, tururë, zhdukje me forcë e personave, deportim masiv, dhuna koloniale etj.

Gjatë këtij simpoziumi, në këto ngjarje do të përpiqen të hedhin dritë personalitetet të njohur siç janë: Mazen Almesber, Manon Bourguignon, Claudine Veuillet-Combier, Jacques Ehrenfreund, Marion Feldman, Betty Goguikian, Muriel Katz, Michèle Grossen, Denis Hirsch, Berdj Pazian, Michaël Petrou, Giuseppe Lo Piccolo, Michaël Prazan, Saskia von Overbeck



Ottino, Régine äaintrater etj.

Një konferencë shumë e dobishme dhe e preferuar për studentët shqiptarë që studiojnë në Zvicër, prandaj pritët që ata të marrin pjesë në një numër sa më masiv.

PARASHIKIMI I MID'HAT FRASHËRIT: SHQIPËRIA DO TË BËHET NJË KAFENE E MADHE!

U promovua vëllimi "Vepra të zgjedhura" të Mid'hat Frashërit që përfshin 60 proza meditative të panjohura. Studiuesi Aurel Plasari gjatë kumtesës së tij zbulon permanencat historike dhe përkimet e hidhura me Shqipërinë e sotme në shkrimet e Mid'hatit

Ndonëse amaneti i Mid'hat Frashërit, alias Lumo Skëndos, për t'u prehur në cepin e kopshtit të Institutit Albanologjik, që ai ëndërronte dhe për krijimin e të cilit la gjithë pasurinë e tij nuk u jetësua, me siguri shpirti i tij do të lehtësohet. Eshtrat e publicistit, shkrimtarit, përkthyesit, albanologut, diplomati, vepimtarit të çështjes kombëtare, politikantit dhe nënshkruarit të Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë, tanimë të kthyer në atdhe do të vendosen pranë memorialit tw Vëllezërve Frashëri në Parkun e Madh, duke u plotësuar kështu edhe dëshira e pasardhësve të tij. Pas dy vëllimeve të para, u promovua ditën e djeshme "Vepra të zgjedhura" të Mid'hat Frashërit, ku përfshihen tregime, skica, rrëfime poetike dhe 60 proza meditative të bëra publike për herë të parë. Gjatë promovimit të librit ishte i pranishëm edhe Ismail Kadare, pasardhës të tij (mbesa Najada Toptani), përfaqësues të institutit "Lumo Skëndo", ambasadori i Kosovës në Shqipëri, studiues, letrarë dhe dashamirës të kësaj figure të rëndësishme kombëtare. Në vëllimin e tretë të botimeve për Mid'hatin, është botuar edhe parathënia "Drama e një lideri" nga Ismail Kadare, një material i shkruar rreth një dekadë më parë nga shkrimtari për dramën "Foleja kombëtare" të Mid'hatit. Në këto faqe Kadare cek gjithashtu problematika të teatrit, por edhe të dramaturgjisë shqipta-

re si dhe rrezikun për një otomanizim të ri të vendit tonë. Gjatë ditës së djeshme u zbulua edhe pamja e skulpturës së Mid'hatit e realizuar nga skulptori Agim Rada.

Ironia therëse e Skëndos për doktorantët që nuk njohin alfabetin deri në fund

Studiuesi Aurel Plasari gjatë kumtesës që mbajti ditën e djeshme në kuadër të promovimit të veprës së Mid'hat Frashërit "Vepra të zgjedhura", shpjegoi se ky vëllim i tretë përbëhet nga shkrime të tij të përmbledhura nën titullin "Duke kënduar një libër".

Këto shkrime, sqaron studiuesi, kanë qene botuar në revistën "Hylli i Dritës", por hera-herës edhe në revistën e tij "Dituria", "Dodona"; "Besa" etj. Plasari shtoi më tej se këto shkrime përfshijnë gati një dhjetëvjeçar (1922-1931). Mandej ai citoi programin e këtyre shkrimeve të përvijuar nga vetë Lumo Skëndo: "Miq të mi të "Hyllit" do të kenë vënë re se në shkrimet që po botoj nën titullin 'Duke kënduar një libër' kujdesi im është t'ju jap një njoftim mbi veprën që botojmë për Shqipërinë dhe t'ju mbajmë koherent me idetë e botës përsa i takon vendit tonë". Kombet si dhe njeriu nuk mund të rrinin indiferentë për opinionin që kanë të huajt për ta. Ç'thonë bota?! Është një pyetje plot bërë që bën i moçmi. Kjo nevojë është edhe më e madhe akoma për ne shqiptarët, një komb i lindur, i ri në jetën politike, një popull i njohur

ligshat dhe mbi të cilin është bërë një propagandë e ligë. Të njohurit e opinionit publik të botës për Shqipërinë s'është pra për ne një kuriozitet, një merak letrar, por më tepër një detyrë politike dhe patriotike".

Mandej studiuesi rrëfeu se Mid'hati i kishte alternuar autorët e huaj në dy çeta shkrimet e tij; në miq ose dashamirës të shqiptarëve dhe në armiq ose rival të tyre. "Të parët, i ka dalluar për objektivitetin, ndershmërinë, paanësinë, singleritetin, seriozitetin, por edhe për kurajën për t'i thënë të vërtetat. Ndër këta shkëlqejnë prej vlerësimeve të tij emra si koloneli Aubrey Herbert, deputeti Justin Godart, Edith Durham, etj. Të dytëve u ka vënë në dukje veset e trillimit, të mashtrimit, të ligësisë dhe të pandershmërisë. Stilin fyes e dekra-tues, deri edhe shitjen e penës".

Megjithatë, Plasari argumenton se Mid'hati tregojë shumë i kujdesshëm dhe eleganc duke i trajtuar si "armiqt pa dashje", pasi që nuk dëshironte që Shqipëria dhe shqiptarët të kishin armiq. Sipas Plasarit balanca e zhdrejtë e ndikimit të të parëve dhe të dytëve, përbën shqetësimin madhor në të gjithë ciklin e shkrimeve të "Duke kënduar një libër". Studiuesi tregon se qysh në fillim të viteve '20 Lumo Skëndo përvijoi edhe programin në trajtë detyrash për të përballuar betejën në atë mejdan siç e quajti. "Detyrat kryesore i ka përshkruar pak a shumë kësh-



tu; 1) Të njohim mirë teknikën dhe armët e përdorura prej kundërshtarëve tanë. 2) Të këndojmë literaturat e tyre politike. 3) T'i bëjmë atë të njohur popullit tonë. 4) T'i përgjigjemi asaj duke ditur si të ruhem i dhe të mbrohemi". Plasari citoi gjithashtu një argument të Skëndos që ka vlera edhe në ditët e sotme: "Bota e di fuqinë e shtypit, pushtetin e botimeve që bren dhe përmbys fortësa". Sipas tij, Lumo Skëndo prej më shumë se një dhjetëvjeçari e kryente atë detyrë, ndonëse për këtë nuk rezultoi të jetë mburrur ndonjëherë.

Aurel Plasari ndër të tjera gjatë kumtesës së tij bëri me dije se pothuajse në çdo faqe të ciklit "Duke shkruar një libër" gjen shumë përkime me realitetin tonë. "Si për çdo popull nuk ka përse të mos funksionojë edhe përshtatëtarët e shumta të përkimeve që ndeshen nuk janë të ëmbla përkundraz!". Studiuesi rrëfen se ndër më pikantet është ngacmimi që ai u bën paaftësisë së doktorëve (doktor, në kuptimin e njerëzve të ditur të Shqipërisë) për të zbritur në fushën e betejave të mendimit politik. Mid'hati shprehej se: "Në një kohë që fletoret e shtypit shtohen si kërpudhat në tokën e plehun, kurse gazetaret shndërrohen në industri na-

cionale, druaj që intelektualët tanë për nga mënyra se si e shkruajnë shqipen nuk e dinë alfabetin e gjuhës shqipe deri në fund. E dinë atë deri tek shkronja v, meqenëse shkronjat, x, z, y, zh, xh përdoren fare pak. Madje ata as që kanë kohë ta nxënë tërë alfabetin e shqipes duke qenë të zënë duke nxjerrë gazeta dhe për të vënë kandidaturnën për tu bërë deputet, prefekt ose ministër. Në vijoftë puna kështu, Shqipëria do të bëhet një kafene e madhe!"

Agron Tufa: Proza e Mid'hatit e ngjashme me atë të Konicës!

Për shkrimtarin Agron Tufa, Mid'hat Frashëri paraqet një lloj shkrimi memuaristik, që sipas tij rivalizon dorë për dorë me letërsinë artistike, pa ja zbehur aspak forcën dëshmisë autentike. "Është qartësia, thjeshtësia, stili i gjallë e dinamik, toskërishtja letrare e kulluar që e shquan prozën e tij në atë nivel të ngjashëm me Konicën, e në disa raste në po ato nivele koniciane shkëlqen edhe ironia therëse e groteske!". Përpos kësaj, Tufa thekson se përgjithësisht prozat memuaristike të Mid'hat Frashërit të shkapërdarë në vite të ndryshme krijojnë kuadro të veçantë historike dhe ndonjëherë psikologjike, zbulime, qëmtime, meditime, asosociacione idesh etj. /SHEKULLI

I ndahet një çmim poetit nga Shkupi, Mustafa Spahiu

Shkup, 26 tetor - Klubi i shkrimtarëve dhe i artistëve "Naim Frashëri", në Përmet përmes qendrës multikulturale ka shpallur konkurs në gjurmët naimiane. Çmimi i dytë Naimi Frashëri i jepet poetit Mustafa Spahiu nga Shkupi për poezinë e dytë më të mirë në edicionin e katërt të konkursit kombëtar të

poezive në gjurmët naimiane organizuar nga Klubi i Shkrimtarëve dhe Artistëve Naim Frashëri-Përmet, Shqipëri". Gjatë këtij konkursi kanë marrë pjesë 60 poet, është botuar një antologjinë poetike, prej këtyre 60 poezive, 30 kanë qenë konkurrese, prej tridhjetëve janë ndarë tre çmime. Shpër-

blimin e tretë sipas atyre që e kanë ndarë e ka marrë Sajmir Velqani nga Durrësi, për poezinë "Copëz e trishtimit hyjnorë", shpërblimin e dytë e ka marrë Mustafa Spahiu "Takim-lotët e zezës", ndërsa shpërblimin e parë e ka marrë Lola Shehi nga Tirana për poezinë "S'ta kam thënë".

Atdhe Gashi promovoi 11 vepra


Regjisori dhe dramaturgu Atdhe Gashi ka promovuar njëmbëdhjetë vëllime me komedi të shkruara në 40 vite karrierë. Në promovimin e këtyre librave në Prishtinë, Atdhe Gashi u vlerësua si një autor senzacional i cili përmes satirës përcjellë edhe mesazhe politike

Gashi edhe pse është në moshën 80 vjeçare, premtoi se gjatë vitit të ardhshëm do t'u sjell lexuesve të tij edhe 11 vepra të tjera.



Rikthehet në librari EKSODI

Pas shume kërkesave të lexuesve, rikthehet libri EKSODI, shkruar nga Leon Uris dhe përkthyer nga: Robert dhe Edvin Shvarc. "Eksodi" është emri i një anijeje me të cilën një grup refugjatësh hebrej, të internuar nga anglezët në një kamp përqendrimit në Qipro, më 1947, arrin të arratiset dhe pas një mijë peripeçish, shkel në Tokën e Premtuar, në Palestinë. Një roman historik i tejmbushur me pasion, me përpjekje, me shpresë dhe dashuri, Eksodi, libri më i famshëm i shkrimtarit Leon Uris, është historia e rilindjes së një kombi pa tokë në kërkim të përjetshëm të një toke pa komb. I shkruar vetëm dhjetë vjet pas lindjes së shtetit të Izraelit dhe i përkthyer në pesëdhjetë e gjashtë gjuhë të botës, ky roman



përshkruan luftën e një kombi të tërë për t'i shkullur rërës së shkretëtirës - dhe mbi të gjitha, urrejtes së njerëzve - një pëllëmbë tokë, mbi të cilën të mund të ringjallet.

LIGA E PARË - JAVA E XI

DETYRË E VËSHTIRË PËR SHKUPIN DHE RENOVËN, SHKËNDIJA E PRET MAKEDONIA GJ.P

"Pobeda këtë kampionat është më e fortë se e vitit të kaluar, ndërsa secili nga futbollistët tanë që do të futet në lojë, do të jep maksimumin për rezultat pozitiv", deklaroi Besart Krivanjeva

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 26 tetor - Të dielën në program janë ndeshjet e javës së 11 në ligën e parë futbollistike të Maqedonisë. Skuadra e FC Shkupi pas fitores në xhiron e kaluar ndaj Sileksit, të dielën do të udhëton drejt Prilepit për tu përballur me Pobedën, të cilët këtë sezon po zhvillojnë një kampionat më të mirë se vitin e kaluar. Ekipi i Shkupit në Prilep do të udhëton për të arktuar tre pikët e reja dhe për të dëshmuar se kanë dalë nga kriza që i kaploi në dhjetë ndeshjet e para të sezonit. Trajneri, Umit Karan për këtë përballje do të ketë një armë më tepër në fushë, pasi është rikthyer nga lëndimi mbrojtësi, Besart Krivanjeva, ndërsa në dyshim për të qenë në formacionin e strategut turk, janë Bllagoja Ljamçevski dhe Basilio Ndong, të cilët kohën e fun-



din janë ankuar në lëndim. "Më gëzon fakti se kalova me sukses lëndimin dhe tani më gati dy javë po punoj me ekipin. Kemi punuar intensivisht edhe gjatë kësaj jave, ndërsa fitorja e fundit vetëm çka e ka ngritur atmosferën, e cila është shumë pozitive me ardhjen e trajnerit Umit Karan. Pres që të fitoj besimin e trajnerit që në ndeshjet e ardhshme ta ndihmoj ekipin, ndërsa për ndeshjen e të dielës mendoj se nuk do të jetë aspak lehtë. Pobeda këtë kampionat është më e fortë se e vitit të kaluar, ndërsa secili nga futbollistët tanë që do të futet në lojë, do të jep maksimumin për rezultat pozitiv", deklaroi Besart Krivanjeva. Nga ana tjetër, Shkëndija e Tetovës pas fitore në derbin e javës së kaluar ndaj liderit Vardarit, të

dielën para tifozëve vendas me qetësi do të pret Makedonija GJ. "Na pret dueli me Makedonija GJ.P dhe përcaktimi mbetet i njëjtë, vetëm fitore dhe tre pikë. Në këtë ndeshje vijmë me atmosferë shumë të mirë pas triumfit kundër Vardarit dhe jemi të vetëdijshëm se përballje të këtilla mund të rezultojnë të rrezikshme nga vetëknaqësia eventuale. Prandaj paralel me pjesën fizike dhe tekniko taktike, ne jemi përgatitur edhe psikikisht për të mbajtur nivelin e koncentritimit njëjtë në çdo ndeshje. Kundërshtari këtë sezon ka treguar se din të befasojë, prandaj ne jemi të bindur për të hyrë me angazhim maksimal për të performuar në nivelin tonë dhe në fund të gëzojmë publikun dhe veten me tre pikë të

TAKIMET E JAVËS SË 11
SHKËNDIJA - MAKEDONIA GJ.P
POBEDA - SHKUPI
VARDARI - RENOVA
SILEKSI - RABOTNIÇKI
AKADEMIJA P - BELLASICA

reja", shprehet mbrojtësi i djathtë, Mevlan Murati. Detyrë e vështirë për skuadrën tjetër shqiptare Renovën, të cilët këtë xhiro do jenë mysafire e liderin të tabelës Vardari. Nga tabori i "gjipsunuesve" shprehen se në këtë përballje do të hynë për të marrë rezultat pozitiv dhe se nuk do të udhëtojnë drejt Shkupit me flamur të bardhë. Në takimet tjera, Sileksi pret Rabotniçkin dhe Akademija Pandev do të jetë nikoqire e Bellasicës. Të gjitha takimet zhvillohen ditën e diel me fillim prej ora 13:30.



Hamburgu i penduar për Mavrajn

Hamburgu ka shkarkuar trajnerin Christian Titz para 3 ditësh. Numri një i stolit i gjermanëve u nda nga klubi për shkak të rezultateve të dobëta që skuadra e tij po merrte në Bundesliga 2. Ekipi legjendar i Gjermanisë që përjetoi rënien për herë të parë nga Bundesliga sezonin e shkuar nuk ishte i kënaqur me punën e tij. Titz e mori ekipin në një kohë krize dhe nuk ia doli dot ta mbannte në Bundesliga. Ai mbahet mend për dorën e hekurit që drejtoi ekipin, pasi përjashtoi nga skuadra dhe Mërgim Mavrajn. Mbrojtësi shqiptar ndau rrugët me gjermanët pikërisht në atë moment për të mos u rikthyer më. Në Bundesliga 2 u mendua se Titz do të kthente ekipin drejt rrugës së duhur, por nuk ia doli mbanë, pasi momentalisht skuadra ndodhet në vendin e 5-të në ligën e dytë gjermane dhe nuk ka shënuar që prej 3 ndeshjen në shtëpi. Kaq ka mjaftuar që drejtuesit të mos besojnë më, pa harruar dhe humbjen shkatërruese 0-5 në shtëpi. Pas shkarkimit, Titz ka gjetur forcën dhe ka lënë disa rresha në profilin e tij në "Facebook" ku tregon keqardhjen për largimin nga Hamburgu. "Qyteti i Hamburgut ka qenë shtëpia ime për 3 vite e gjysmë. Kush e kishte menduar këtë?! Kam punuar me U-17 dhe U-21 dhe strategjia e zhvillimit ishte pjesë e filozofisë. Në mars, mu dha mundësia të marrë ekipin e parë. Ishte një kohë shumë e ngarkuar dhe e bukur për mua dhe familjen time. Dua t'i uroj Hamburgut të arrijë realizimin e objektivave", tha ndër të tjera Titz.

Shaqiri mezi pret të luajë në Beograd

Reprezentuesi i Zvicrës ishte gjithë me 10 mijë franga nga FIFA për "sjellje josportivë" pasi kishte festuar me shqiponjën dykrenore ndaj Serbisë në momentin e golit të fitores në fund të takimit. Kështu shkruan prestigjiozja "The Guardian" në një artikull të së enjtes për yllin kosovar. "Shaqiri ishte i lindur në qytetin e Kosovës, Gjilan, dhe barti flamurin e Kosovës në këpucët e ndeshjes së Grupit E, duke nxitur reagim të Federatës së Futbollit të Serbisë", thuhet më tej në këtë artikull. Transferimi i kësaj

vere i Liverpoolit do të udhëtojë drejt Serbisë për përballjen me Çërvena Zvezdën në Beograd në Ligën e Kampionëve. Drejtori sportiv i klubit serb, Zvezdan Terziq, kishin thënë se 27-vjeçari duhet të mos udhëtojë për shkak se nuk mund të garantohet siguria. Ndërsa tani ish-ylli i Stoket është përgjigjur duke thënë se s'ka pse të mungojë në ndeshjen e 6 nëntorit në stadiumin "Rajko Mitiq". "E kam pasur këtë në Botëror dhe di ta menaxhoj pa problem. S'ka shqetësim. Kam parë disa artikuj ku një futbollist ka thënë



diçka. Në të vërtetë nuk merakosem se çfarë thonë njerëzit. Shkoj të luaj një ndeshje futboll. Nuk është politikë, është futboll. Nuk brengosem dhe shkoj të luaj", ka thënë Shaqiri.

Ai shkëlqeu në takimin e parë mes dy skuadrave, të mërkurën në Anfield duke asistuar në golin e dytë dhe duke kontribuar shumë në të parin, në fitoren 4 me 0.

Hysaj mbulohet me flori, strategjia e Napolit dhe nyja e klauzolës

Në dy ndeshjet më të rëndësishme të Champions, Napoli-Liverpool dhe PSG-Napoli, Elseid Hysaj është akomoduar në stol, duke ndjekur për 180 minuta në total si spektator pa pagesë. Zgjedhje që nuk është se kanë kënaqur shumë mbrojtësin e Shqipërisë, i cili është nga ata lojtarë që duan të jenë gjithmonë në fushë. Sidomos nëse luhet himni i Champions League. E

megjithatë, shkodrani shihet si një pasuri për ekipin axurr dhe për këtë arsye, agjenti i tij, Mario Giuffredì, po bisedon prej disa ditësh me drejtorin sportiv të axurrëve, Cristiano Giuntoli, për të gjetur një akord për rinovimin e kontratës aktuale, që skadon në 2021. Hysaj fiton aktualisht 1,8 mln euro në sezon, por kërkesa e re, nisur edhe nga merkato dhe interesimet e

vertës, është 3 mln në sezon. Mund të mbyllet gjithçka në 2,5 mln euro. Pra, do t'ia kalonte edhe rrogës së dikurshme të Lorik Canës, që te Lacio fitonte 2 mln euro në sezon. Madje, sipas asaj që thuhet në shtypin italian, firma mund të vije edhe në periudhën e dhjetorit. Një tjetër nyje e rëndësishme për t'u zgjidhur ka të bëjë sidomos me klauzolën për prishje kontrate. Për



jashtë Italisë ajo mbetet e fiksuar në 50 mln euro, ndërsa agjenti i shqiptarit kërkon që ta ulë atë, ose

ta heqë. Napoli nuk është dakord dhe bisedimet kanë ngecur pikërisht në këtë çështje.



DE GEA TE JUVENTUSI

Kampionët italianë Juventus kanë një plan afatgjatë për të afruar portierin e Manchester Unitedit dhe Spanjës, David De Gea. Mediumi The Times raporton se trajneri i Unitedit, Jose Mourinho, është i shqetësuar se portieri spanjoll do të largohet drejt Bianconerëve në një transferim të lirë, kur skadon marrëveshja e tij në Old Trafford

Jose Mourinhos po i shtohet frika se David De Gea mund të largohet nga Manchester United për te Juventus, sapo kontrata e tij në "Old Trafford" të mbarojë. Kështu raporton tabloidi britanik, "The Sun". Portieri spanjoll ka hezituar të nënshkruajë një zgjatje të kontratës së tij aktuale, e cila skadon verën e vitit 2019, por mund të ketë fuqi ligjore automatikisht edhe një vit, nëse duan "Djajtë e Kuq", sipas klauzolës përkatëse. Juventus ka fituar një reputacion për joshjen e talentëve të nivelit të lartë, që dalin të lirë, dhe duket se është i interesuar edhe për De Gea. Kjo gjë mund të bëjë që Manchester United ta shesë atë me çmim të ulët

në verën e vitit të ardhshëm, në vend që ta humbasë për asgjë. Kuptohet se spanjoll, 27 vjeç, është i vetëdijshëm se gjigantët e Torinos e duan atë, kur marrëveshja e tij të skadojë verën e ardhshme. Manchester United ka mundësinë ta zgjerojë atë edhe për një vit të mëtejshëm. Por, një burim nga "Old Trafford", pranoi: "De Gea luajti kundër klubit të tij të ardhshëm, të martën. Juventus është një klub ekspert për marrëveshje inteligjente. Nëse Manchester United nuk e shet atë në verë, Juventus do të presë deri në fund të kontratës së portierit spanjoll". Trajneri i Juventusit, Max Allegri, është i gatshëm të presë për të blerë një nga por-

tierët më të mirë në botë, me pametra zero. Kjo do t'i irritonte shefat e "Old Trafford", të cilët panë një 19-vjeçar si Paul Pogba të kalonte në Itali si lojtar i lirë, në vitin 2012, kur kontrata e tij me "Djajtë e Kuq" mbaroi. Më vonë, Manchester United shpenzoi një shumë rekord botëror prej 89 milionë paund për ta rikthyer ndërkombëtarin francez në "Old Trafford", në vitin 2016, pasi kishte shpërthyer te bardhezinjtë e Torinos. Ishte pritje gjerësisht që De Gea të firmoste një marrëveshje të re afatgjatë me Manchester United, por situata jo fort pozitive, sidomos ajo rezultative, e klubit anglez e ka bërë të hezitojë, duke menduar për një destina-

cion tjetër. Pasi ka rënë poshtë pista "Real Madrid", sepse atje shkojnë këtë verë belgu Thibaut Courtois, portieri spanjoll duket i joshur nga Juventus, që ka fituar 7 titujt e fundit radhazi në Seria A dhe synon suksesin në Champions, tashmë.

Natyrisht, shkuarja e Cristiano Ronaldos te "Zonja e Vjetër" përbën një lloj magneti edhe për yje të tjerë. Juventus ka afruar më parë superstarë me kosto zero, si Dani Alves, Andrea Pirlo dhe Sami Khedira, ndaj nuk është aspak çudi që ta vijojë këtë rrugë me De Gea, i cili do të ishte zëvendësuesi më ideal i Gianluigi Buffon, tashmë i transferuar te PSG në moshën 40-vjeçare.



Rrëfihet Wozniacki: Jam e dëshpëruar, kam 3 muaj që luaj e sëmure

Tenistja 28-vjeçare daneze Caroline Wozniacki, numri 2 në botë, vuan nga sëmundja e "artritit reumatoid", me të cilën është diagnostikuar para grand slam të US Open. Lajmin e ka konfirmuar sot vetë tenistja daneze, në përfundim të ndeshjes së humbur ndaj ukrainases Elina Svitolina, në raundin e fundit të fazës së grupeve të WTA Championship (Singapor). Kjo humbje e eliminon danezen nga ky turne, duke mbyllur kështu sezonin. "Në fillim edhe për mua ky lajm ishte një "shock", pasi jam një sportiste kampione dhe krejt papritur e sheh veten se duhet të bashkëjetosh me këtë problem. Në të tilla raste duhet të ndihesh pozitive dhe të përballësh me problemin e më pas të ndihesh sa më në formë", tha Wozniacki. Tenistja ka rrëfyer se nisi të ndihej e lodhur pas grand slam të Wimbledon dhe se një mëngjes, në turneun e Montreal nuk ngrinte dot krahitë. Më pas, për shkak të këtij problemi, u tërhoq nga turneu i Sinsinatit, që në raundin e parë. Pasi është vizituar ajo ka mësuar për këtë sëmundje, "artritit reumatoid", një sëmundje autoimune, që shkakton fryrje dhe lodhje. Wozniacki ka nisur mjekimin për të kuruar këtë sëmundje, duke thënë se ky problem nuk do të ketë asnjë ndikim në karrierën e saj.

Italianët dominojnë provat e lira në pistën australiane të Phillip Island

Surpriza në provat e lira të zhvilluara sot në pistën australiane të Phillip Island, të vlefshme për Botërorin e Moto GP. Piloti italian Andrea Iannone me Suzuki ka qenë më i shpejtë në pistë, duke dhënë kohën 1'29"131, duke lënë pas prapësirin e tij me Ducati Pramac, Danilo Petrucci.

Dy emra surprizë, ndërkohë që i treti u klasifikua spanjoll i Yamaha, Maverick Viñales e pas tij Andrea Dovizioso me Ducatin zyrtar.

Vetëm i shtati Marc Marquez me Honda, kampioni i saposhpallur i botës për vitin 2018, që nuk aq i shpejtë sa pritej, ndërsa Valentino Rossi me Yamaha u klasifikua në vendin 10-të. Probleme për britanikun Cal Crutchlow, që u rrëzua gjatë provave të lira dhe pësoi dëmtime të rënda, përfshi edhe disa fraktura. Ai u dërgua në spital, por sezoni i tij është i mbyllur, pasi rikuperimi kërkon të paktën 1 muaj kohë.



VETTEL: NUK JAM I PAAFTË, TITULLI NUK VARET MË NGA UNË

Piloti gjerman Sebastian Vettel pranon se kohët e fundit nuk kanë qenë shumë të mira për të dhe se ky sezon ka qenë me dy pamje, i mirë në pjesën e parë dhe zhgënjyes në pjesën e dytë. Aksidentet e shpeshta që ka patur kohët e fundit kanë hedhur dyshime mbi aftësitë e pilotit gjerman, por Vettel ka ditur të përgjigjet. "Unë nuk jam një budalla që të shkojë të përplasem me kolegët e mi.

Nuk jam aq idiot sa të kërkoj paraklime të pamundura, por gjithnjë gjykoj në bazë të shumë faktorëve. Për fat të keq kam pa-



tyr kontakte në dy gara që më kanë penalizuar në garë", tha Vettel.

Kontaktet me pilotët e Red Bull, Verstappen në Japoni dhe

Ricciardo në Amerikë kanë penalizuar shumë ferraristin. "Unë

shoh përpara, nuk jam shumë entuziast, pasi shoh se humba një mundësi të artë për titullin kampion.

Në ditët e fundit, madje në javët e fundit, kemi punuar për vitin 2019, në mënyrë që të jemi sa më të përgatitur kur të nisë sezoni i ri", thotë Vettel. Piloti i "kokëkuqes" që duket i dorëzuar në betejën për titull. "Matematika thotë që jemi ende në garë, por tashmë nuk varet më nga ne beteja për titull. Nuk mendoj se Botërorin e humba unë, por e fitoi Hamilton. Kush fiton i ka të gjitha meritat", tha Vettel.

INTERI NJOFTON RINOVIMIN E KONTRATAVE TË GJASHTË LOJTARËVE

Nerazzurrit kanë shpërblyer gjashtë nga lojtarët kryesor me kontrata të reja. Është vet klubi italian që ka njoftuar rinovimin e kontratave me lojtarët e tyre, kontrata që variojnë nga viti 2020 deri më 2023

E shkuara tashmë është pas krahëve dhe Interi po mendon për të ardhmen. Pasi mbyllja e bilancit në 30 qershor 2018, sa i përket sezonit që lamë pas, ka qenë pozitive, kanë nisur rinovimet e para për disa futbollistë. Mes tyre edhe Marcelo Brozovic, protagonist me Kroacinë në Botërorin e fundit rus. Por, sidomos me hedhjen e tij në formë "kokodrili" gjatë goditjes së dënimit të Suarez, duke u vendosur pas barrikadës dhe duke u shtrirë, për të ndaluar një top që mund t'i drejtohej rrjetës. Mesfushori kroat, përveç se ka firmosur deri në vitin 2022 (kontrata aktuale i skadonte në 2021), do të ketë edhe një rrogë më të lartë, por sidomos tashmë klauzola për prishje kontrate do të shkojë në



60 mln euro dhe bëhet fjalë për jashtë vendit. Kjo marrëveshje e re bëhet për faktin se zikalërit duan të përfitojnë nëse e shesin, por u vendos 60 mln euro pasi lojtari nuk do të ishte dakord për më shumë, nëse kërkohet jashtë. Mesfushori u transferua në Milano në verën e vitit 2015 nga skuadra e Dinamo Zagreb për shifrën mbase 8 mln euro dhe sot kushton thuhet 8-fish më shumë. Këtë sezon, trajneri Luciano Spalletti po e aktivizon si regjist përpara mbrojtjes, për të ndërtuar aksio-

net. Një rol ku Brozo po shkëlqen dhe ka gjetur veten, pas një viti me dritëhije. Interi ka njoftuar rinovimin e kontratave edhe me pesë lojtarë tjerë të skuadrës edhe për shumë vite të ardhshme, kështu me Brozovic i bie që Nerazzurrit kanë shpërblyer gjashtë nga lojtarët kryesor me kontrata të reja. Është vet klubi italian që ka njoftuar rinovimin e kontratave me lojtarët e tyre, kontrata që variojnë nga viti 2020 deri më 2023. Me kontratë të re deri në vitin 2022 është bërë edhe me-

sfushori uruguian, Matias Vecino. Rinovimi i kontratës ka ardhur edhe për mesfushorin italian, Antonio Candreva, i cili do të jetë zikalër deri në vitin 2021. Mbrojtësi Henrique Dalbert dhe mesfushori Roberto Gagliardini kanë përfutur kontratat më të gjata, ndoshta edhe shkaku i mosshës më të re, kanë rinovuar deri në vitin 2023. Në anën tjetër, mbrojtësi brazilian, Joao Miranda do të jetë i Interit edhe për sezonin e ardhshëm, pra deri në verën e vitit 2020.



Po mrekullon në Seria A, Chelsea ofron 35 milionë për sulmuesin

Maurizio Sarri e ka "fukur" në rreth" sulmuesin 23-vjeçar të Genoa, Krzysztof Piatek, pas humbjes së besimit tek Alvaro Morata. Por, klubi i Seria A është i vendosur të fitojë një shumë të madhe nga ndërkombëtarit polak, nëse e shet atë në janar. Synimi i Chelsea mbetet ky lojtar, për të cilin mund të ofrojë deri në 35 milionë funte. Kuptohet që Chelsea e ka shprehur interesin e vet të qartë përmes ndërmjetësve e palëve të treta, me mundësinë e një lëvizjeje kur të hapet merkatoja në janar. Piatek ka shënuar 17 gola këtë sezon, duke përfshirë 4 gola për vendin e tij, çka ka rënë në sytë e klubeve më të mira të Europës. Inter, Roma dhe Napoli nga Italia, por edhe klubet e tjera angleze, po e monitorojnë situatën e tij. Genoa pagoi vetëm 3,5 milionë £ për ta marrë lojtarin nga Cracovia këtë verë, ndaj mund të joshet për ta kthyer në një fitim të shpejtë dhe shumë të madh, duke e shitur atë. Një lëvizje në fund të sezonit duket më e mundshme se në janar, edhe pse agjenti i lojtarit zbuloi se Piatek po e shijon kohën e tij në Genoa, skuadër e cila është në vendin e 9-të të Seria A. Szymon Pacanowski tha: "Shumë klube na kanë kontaktuar gjatë javëve të fundit. Vlera e tij është rritur me siguri gjatë tre muajve në Seria A, por tani për tani jemi të lumtur të qëndrojmë te Genoa".



Neymar kërkon largimin nga PSG

Barcelona ose Real Madrid, por jo më në Paris. E ardhmja e Neymar duket e sigurt, dhe me kalimin e muajve zërat për një rikthim të tij në La Liga priten të shtohen akoma më shumë. Braziliiani ka kujtime shumë të mira tek katalanët, me ish-shokët e ekipit që janë gati për ta mirëpritur sërish. Por, në qoftë se kjo pistë është e parealizueshme, O'Ney është gati të shkojë tek "Los Blancos", njësoj si patrioti i tij, Ronaldo fenomeni. Pavarisht se tek PSG e trajtojnë si një mbret, Neymar nuk është fort i kënaqur me aventurën e tij në Francë, më shumë prej situatës, se sa prej qytetit. Sipas mediave spanjolle, 26-vjeçari i ka rrëfyer shokut të skuadrës tek kombëtarja, Arthur, i cili luan gjithashtu tek Barcelona, se është gati për një rikthim në Katalunjë, duke

shfaqur pendesë për largimin e tij 1 vit më parë. Gjithsesi, gjithmonë ka një problem. Nëse liderët e ekipit "blaugrana", si Pique apo Messi, i kanë kuptuar arsyet e largimit të tij, dhe gjithsesi e konsiderojnë Neymar si pasardhësin e argjentinasit në skuadër, drejtuesit nuk e kanë aprovuar akoma një rikthimin të brazilianit. E vështirë do të ishte dhe arritja e një marrëveshjeje me parizenët. Këta të fundit, do të kënaqeshin me kartonin e Ousmane Dembélé, që do të bashkohej me shokun e tij të ngushtë Kylian Mbappe, por dhe me një shumë të konsiderueshme parash. Por, në rast se gjërat nuk funksionojnë me Barçën, Real Madrid qëndron gjithmonë gati, me Florentino Perez që nuk e ka fshehur kurrë admirimin e tij për O'Ney.

Dani Alves: Askush nuk është si unë

Joao Cancelo ka pushtuar Europën. Në fakt, një fillim i mirë i sezonit ishte i mjaftueshëm për Juventusin, që ai të përfundojë në qendër të mediave dhe të katalizojë vëmendjen e të gjithë lojtarëve të mëdhenj. Aq shumë vlerësimet ka marrë, sa dikush siguron se si Barcelona ka identifikuar te Cancelo kandidatin numër një për

krahun e djathtë, ku do të mbushë boshllëkun e lënë tri vite më parë nga lamtumira e Dani Alves. I njëjti, Dani Alves, megjithatë duket se nuk mendon në të njëjtën mënyrë, ndaj në Twitter ka komentuar lajmin: "Askush nuk është si unë". Ky status është shpërndarë nga një fyturë me lot në sy (emoji). Shkurtime, ky pronon-

cim i brazilianit duket më shumë si një shaka, por debati tani është i hapur: a mund të jetë Cancelo me të vërtetë Dani Alves i ri? Cilësitë teknike të mbrojtësit të Juventusit me siguri nuk mungojnë, por fjala e fundit do të jetë gjithnjë në fushë. Koha për të bindur edhe skeptikët, edhe vetë Dani Alves, nuk mungon.



SUAREZ FLET PARA "EL CLASSICO"

NJË EKIP ËSHTË MBI ÇDO LOJTAR

"Ndesjjet ndryshojnë nga njëra tjetra, kjo vlen edhe për "El Classico". Në përplasjen e fundit të sezonit të kaluar me Real Madridin ishim kampionë, por kemi luajtur me intensitet të madh. Në ballafaqime të tilla nuk mendon se si vjen kundërshtari psikologjikisht. Kjo është "El Classico" dhe duhet përjetuar plotësisht", ka deklaruar Suarez

Qendra e sulmit të kampionëve në fuqi të La Liga-s, Luis Suarez, dha një intervistë për mediat zyrtare të Barcelonës, ku foli edhe për "El Classico" e së dielës në "Camp Nou". Me lëndimin e Leo Messit, urugujani do të ketë, nëse është e mundur, më shumë rëndësi për ta mposhtur Real Madridin.

"El Classico" janë të ndryshme - "Ndesjjet ndryshojnë nga njëra tjetra, kjo vlen edhe për "El Classico". Në përplasjen e fundit të sezonit të kaluar me Real Madridin

ishim kampionë, por kemi luajtur me intensitet të madh. Në ballafaqime të tilla nuk mendon se si vjen kundërshtari psikologjikisht. Kjo është "El Classico" dhe duhet përjetuar plotësisht. Të luash në "El Classico" është një ndjenjë e veçantë. Falë publikut të rritet edhe më shumë adrenalina. Cilido lojtar dëshiron vetëm të fitojë. Janë momente shumë të bukura në karrierën e gjithkujt".

Lopetegui - "Real Madridi ka një trajner të ri dhe kjo është gjith-

monë një motivim shtesë për lojtarët, për të treguar se ata meritojnë të luajnë. Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse Real Madridi ka lojtarë me cilësi të mëdha, që mund të bëjnë ndryshimin. Por, si çdo rival, edhe Real-i ka dobësitë e tij, që duhet të shfrytëzohen".

Mungesa e CR7 - "Ne të gjithë e dimë se çfarë lloj lojtari është Cristiano, por një skuadër është mbi çdo lojtar. Real Madridi ka lojtarë të tjerë të mëdhenj, që bëjnë



ndryshimin. Ne duhet ta bëjmë lojën tonë pa menduar se cilët lojtarë ka apo jo kundërshtari".

Ai luan mirë në "El Classico" - "Mbam mend fitoren 2-1 në "Camp Nou", në vitin tim të parë me Barcelonën. Një fitore, që pothuajse na dha titullin në La Liga. Më pas kam luajtur disa lojëra të tilla. Më e rëndësishmja ishte ajo, kur shënova golin tim të parë. Gjithashtu, rezultati 0-4 në "Bernabeu". Eshtë

gjithmonë mirë për të fituar atje, aq më tepër duke shënuar dy gola".

5-0, kujtimet e vitit 2010 - "Ajo fitore do të kujtohet gjithmonë. 5-0 në "Camp Nou" e kam jetuar si një tifoz, si spektator. Po ashtu, goli i Ronaldinhos ndaj Real Madridit, në vitin 2005. Ato janë kujtime. Kur isha tifoz, kam gëzuar shumë, tani po e bëj si një lojtar. Janë situata të ndryshme"

Publicitet



Steven Zhang bëhet presidenti më i ri në historinë e Interit

Tashmë nuk ka më dyshime pasi gjithçka ka marrë trajtën zyrtare. Ashtu siç edhe parashikohej Steven Zhang është presidenti i ri i Interit duke pasuar në këtë detyrë indonezian Erick Thohir, post të cilin ky i fundit e mbante që nga nëntori i vitit 2013, vetëm pak muaj pasi u bë pronar i mazhorancës së aksioneve të klubit zikaltër. Steven Zhang bëhet kështu presidenti më i ri në historinë e Interit pasi është vetëm 26 vjeç. Që nga momenti që kinezët e Suning Group blenë nga Thohir 69% të aksioneve të Interit, djali i pronarit të klubit Zhang Jindong ka qëndruar gjithmonë në Milano duke ndjekur me interes të gjithë aktualitetin zikaltër dhe duke mbështetur skuadrën me praninë e tij në stadiume përkrah zëvendës-presidentit Javier Zanetti. Në asambleshë e klubit përveç se është vendosur largimi i Erick Thohir me Suning Group që ka blerë edhe 30% e aksioneve që zotëroheshin nga indoneziani është përzgjedhur edhe Zhang Jr, si president i ri, me klubin zikaltër.

Me Vip Biznes mundeni më shumë!

Bëni një lëvizje të mirë dhe zgjidhni një biznes partner që në mënyrë të përkryer do të përshpejtojë biznesin tuaj. Punoni dhe komunikoni pa kufizime, kudo që t'ju shpër biznesi.

Zgjidhni Vip Neo L dhe XL dhe qëndroni në rrjedhë me biznesin tuaj edhe kur jeni jashtë vendit sepse tani fitoni 200MB internet në roaming çdo muaj, deri në fund të kontratës. Interneti i përfshirë në roaming mund të përdoret në 50 operatore/vende në Evropë dhe në SHBA, ndër të cilët: Vip Mobile Serbi, AT Bullgari, Vipnet Kroaci, Vodafone në Greqi, Shqipëri, Turqi, Itali, Gjermani, Sponji, Telenor Mali i Zi, Monaco Telecom Kosovë, AT & T në SHBA dhe të tjerë që mund t'i shihni në www.vip.mk.

Oferta është e vlefshme një periudhë të kufizuar për kontratë të re ose kontratë të ripërtëritë e kontratës në 24 muaj.

Për më shumë informata, vizitoni faqen tonë të internetit www.vip.mk ose telefononi në 077 1234.



DASHI 21. mars - 20. prill

Duhet të vlerësoni mundësitë e reja në vendin e punës, pasi mund të garantojnë më shumë stabilitet. Kjo është diçka shumë e rëndësishme, sidomos për gjithë ata që kanë dëshirë të hedhin baza solide për të ardhmen e tyre. Në dashuri, kjo e premtë do të mbrojë historitë e reja.



DEMI 21. prill - 21. maj

Do të jeni shumë të sinqertë dhe të drejtëpërdrejtë në bashkëpunimet tuaja, sidomos nëse ndaj sjelljeve të dëmshme në punën tuaj. Të qenit autoritar do ju lejojë që të riktheheni në lojë dhe të merrni një rol më të shumëpërgjegjës. Sa i takon dashurisë, parashikohen takime të reja interesante.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Ndriqni më shumë sugjerimet dhe këshillat e kolegëve tuaj, pasi nëse do të jeni krenarë rrezikoni vetëm që të ngarkoheni me shumë përgjegjësi, gjë që mund të shkaktojë edhe shpërndirje. Në dashuri do të viheni përballë një zgjedhjeje të rëndësishme.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Jeni optimistë dhe pozitivë dhe kjo në sajë të propozimeve mjaft të mira që keni marrë së fundmi. Sigurisht ka edhe disa çështje të hapura, por nëse do të dini si ti menaxhoni, dialoget mund të sjellë kompromise mjaft të vlefshme.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Parashikohet një ditë e cila do ju lejojë që të vlerësoni më mirë ndjenjat dhe familjen. Duhet të merrni më shumë kohë, për të forcuar këto lidhje. Në mbërmeje do të jeni tejet romantik.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Më në fund do mund të lini pas kraheve veset negative si në sferën e ndjenjave edhe në atë profesionale. Jini të sigurtë për një zgjedhje që duhet të bëni, pasi marrja e shumë rreziqeve përsipër, mund të shkaktojë stres dhe konfuzion të madh.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Mos arrini në konkluzione shumë të nxituara sidomos në vendin e punës. Intuita e mirë do ju lejojë që të zgjidhni çdo problem, edhe në minutat e fundit. Në dashuri jeni në kërkim të pikave të reja të referimit, por duhet të dëgjoni më shumë edhe nevojat e partnerit/ës.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Parashikohen mundësi shumë të mira për të çuar deri në fund disa projekte të cilat gjatë javëve të fundit i keni frenuar. Në dashuri, duhet të jeni më të komunikueshëm.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ka disa të papritura të cilat do ju detyrojnë të rishikoni prioritetet tuaja në vendin e punës. Mos jini të tensionuar, pasi çdo acarim rrezikon që t'iu shpërqendrojë. Nga pikëpamja sentimentale, parashikohen mundësi shumë të mira për të zyrtarizuar një raport dashurie.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Mos lejoni që të ndikoheni nga polemikat e të tjerëve, pasi intuita juaj e shkëlqyer do ju lejojë që të arrini një sukses të madh. Mbrëmja do të jetë relaksuese dhe do ju lejojë që të pushoni më shumë dhe të kaloni më shumë kohë me familjen. Këshillohet që të bëni kujdes me shpenzimet.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Në vendin e punës do të bëni në sy, për shkak të vigjilencës suaj dhe kjo pasi do të jeni të vendosur në arritjen e disa objektivave të mëdha, shkruan noa.al. Kjo është një fazë e rëndësishme rikuperimi në dashuri, ku parashikohet lindja e historive të reja të dashurisë.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do të dini që të shfaqeni të zgjuar dhe do e kaloni pjesën më të madhe të ditës me një mik ose koleg që ndodhet në vështrësi. Duhet të jeni gati të përballoni ndonjë keqkuptim të vogël në familje.

FJALËKRYO KLASIK

HORIZONTALISHT: 1. I federatës; 7. Çela diçka; 8. Qytet në Rumani; 10. Secila nga anët e një sendi; 11. Përbërëse e alkoolit; 13. Shkruaj; Sh. P.; 14. Markë e njohur e cigareve; 16. Hyjnesha e fatit në mit. Greke; 18. Përemër pronor; 19. Zë me dorë, e rrok; 20. Vetëvrasje e samurajëve japonez; 23. Kalcium; 24. I pagjak; 25. Mbart; 27. Akademik (shkurt); 28. Kopsht i madh, që shërben si vend pushim; 29. Mungesë dhembjesh (mjek).

VERTIKALISHT: 1. Fair Average Quality; 2. Përkulem; 3. Dante Aligjeri; 4. Lloj qeni i cili gjuan minjtë (zool.); 5. Banor i vendeve arabe; 6. Vjedhës; 7. Burgu (vjet.); 9. I volitshëm a i lehtë në përdorim; 10. Mbudova, maskova; 11. Mjell gruti, misti etj., i bluar trashë; 12. Bari lopësh; 15. Një sport lufarak; 17. Lloj palme; 21. Kryeqyteti i Jordanisë; 22. Simbol i fesë myslimane, besim; 26. Vegël muzikore frymore; 28. Numri i Ludolfit.

ZGABURJET A. P. LUMOROC, ZYVARTI, PUKETET, BALENA, DEPRAT, A. K. B. LUMOROC, AUTOGRAF, M. JAKOVIC, KONJ, BALESTON, NIK, DENKAL, SHARTE, HAN, ANAD, FRADE, ETJANOL, SHI, HAN, BOHO, DSA, ME, KAVI, HANNOE, CA, ANDREA, TIBAVI, JAVO, PAVI, ANDRINI, HOC, ROKU, L. EV, MAL, AKK, SHALTESNA, ME, E, DOKTORI, OTORINOLOG, KAMAR, ANITA, LRI, KAVAS, FJALËKRYO KLASIK, FEDERAL.

I PËRDOR GJITHË BOTA, PILULA E PRESIONIT TË GJAKUT SHKAKTON KANCER

Pilulat e presionit të gjakut të marra nga miliona njerëz në mbarë botën mund të rrisin rrezikun e kancerit të mushkërive. Në këtë konkluzion kanë dalë shkencëtarët që kanë kryer një hulumtim për pacientët që përdorin "frenuesin" ACE. Rezultoni se ata kanë 14% më shumë gjasa për t'u prekur nga kanceri vetëm se përdorin këto pilula gjatë mjekimit.

Ata që i merrnin ato për pesë vjet e kishin nivelin e rrezikshmërisë nga preklja prej kancerit të mushkërive në 22%, ndërsa shkon deri në 31% për ata që i përdorin prej dhjetë vitesh. Shkencëtarët besojnë se këto pilula shkaktojnë akumulimin e kimikateve të quajtur "bradikinin" në mushkëri, e cila çon në kancer. Por ekspertët të tjerë hedhin dyshime mbi rezultatin dhe vënë në dukje se kanceri i mushkërive mund të shkaktohet thjesht nga pirja e duhanit.

Deri në pesë milionë pacientë në Britani të Madhe, ku u bë studimi përdorin



rehabilituesit e presionit të gjakut të njohur si ACE. Frenuesi ACE më i zakonshëm, i quajtur "Ramipril" është përdorur më shumë 27 milionë herë në Angli në 2017, duke xhiruar 41 milion paund në ekonomi. Emra të tjerë të zakonshëm

përfshijnë kapopril, cilazapril dhe enalapril. Të gjithë këto reduktojnë aktivitetin e enzimës konvertuese të angiotensinës, ose ACE dhe duke bllokuar këtë enzimë, enët e gjakut relaksohen dhe zgjerohen duke ulur tensionin e gjakut.



Birra dhe akullore falas nëse përdorni biçikletën në Bolonja

Arkitëkti urban Marco Amadori mendoj një mënyrë të zgjuar për të nxitur sa më shumë njerëz që të udhëtojnë me biçikletë ose të përdorin transportin publik. Në vitin 2017 ai nisi zbatimin e një skemë kundër ndotjes, shpërbllim për këdo që përdor biçikletën. Njerëzit në Bolonja dhe turistët e saj janë shpërblyer për drejtim e biçikletës, përdorimin e transportit publik apo edhe për ecjet në këmbë. Ajo që duhet të bëni nëse vizitoni Bolonjën është të shkarkoni aplikacionin dhe të regjistroni udhëtimin tuaj. Në fund do shpërblleni me birra, akullore ose bileta kinemaje falas.

Facebook me program kundër imazheve nudo të fëmijëve

Facebook njoftoi të mërkurën se ka vënë në përdorim një program të ri, që sinjalizon për imazhe lakuriq të fëmijëve. Programi e kishin ndihmuar kompaninë të hiqte 8.7 milionë fotografi të tilla, gjatë tre muajve të fundit. Facebook-u tha se programi është vënë në përdorim gjatë vitit të kaluar dhe përmirëson identifikimin e përmbajtjeve të papërshtatshme, ndërsa analizon një numër masiv fotosh në rrjetet sociale. Kompania njoftoi se po i forcon masat e kontrollit për të mbështetur politikën e

saj të ndalimit të fotografive të të miturve me përmbajtje seksuale. Programi po ndihmon në efikasitetin e ekipit të trajnuar për përmbajtjet problematike kundrejt miliarda postimeve që bëjnë përdoruesit e Facebook-ut çdo ditë. Facebook-u njoftoi gjithashtu se ka nisur të përdorë dhe një program që identifikon përdorimin e rrjetit social për të krijuar shoqëri me të mitur me qëllim shfrytëzim seksual të tyre. Gjigandi i medias sociale tha se do të zbatojë të njëjtën teknologji dhe në Instagram.



Australia përgatitet për verë të vështirë, temperaturat mbi 40 gradë

Australia pritet të goditet nga një valë ekstreme të nxehti këtë javë, me temperatura deri në 40 gradë Celcius, duke sjellë kështu në vend një verë të parakohshme. Pritet që nga kjo valë e të nxehtit të preket pjesa më e madhe e vendit dhe temperaturat të arrijnë në 40 gradë gjatë fundjavës, më e larta që prej fundit të verës në shkurt. Siç shkruan DailyMail, në vende si Queensland temperaturat do të shkojnë deri në 43 gradë, ndërsa ato parashikohet të ulen me 2-3 gradë në fillim të javës. Sipas ekspertëve, i nxehti ekstrem sidomos në zonat verilindje të vendit vjen si pasojë thatësirës së madhe të tokës. Edhe më herët, australianët janë paralajmëruar për një verë të gjatë e përvëluese.



312 – Konstantini i Madh thuhet të ketë pranuar Vegimin e tij të njohur në lidhje me Kryqin.

1492 – Kristofor Kolombo zbulon Kubën.

1523 – Trupat angleze okupojnë Montalidier Françë.

1644 – Beteja e dytë e Njuberit: Mbreti Çarls I mund ushtritë parlamentare.

1676 – Polonia dhe Turqia nënshkruajnë marrëveshje të paqes në Varshavë.

1682 – Themelohet qyteti i Filadelfisë në Pensilvani.

1806 – Ushtria franceze futet në Berlin.

1867 – Garibaldi marshon në Romë.

1913 – Presidenti Uilson thotë se SHBA asnjëherë nuk do të sulmojë asnjë shtet.

1941 – Nazistët formojnë geton e jevgjeve në Beograd.

1944 – Tito arrinë në Beogradin e lirë.

1971 – Republika e Kongo-Kinshasa do të quhet Republika e Zairit

1982 – Kina shpallë se popullsia e saj ka arritur në 1 miliard banorë.

2005 – Fillojnë protestat në Paris pas vdekjes së dy tinejxherëve mysliman.

KALENDARI HISTORIK 27 TETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA


THËNIA E DITËS

Kompania amerikane "Ray's Sausage" shpenzoi mbi 20.000 dollarë për të përmirësuar prodhimin e sallameve të saj në Klivlend



të Ohajos, për shkak të ankësimeve të vazhdueshme nga konsumatorët për aromat e këqija. Në fakt, era e rëndë vinte nga viktimat e dekompozuar të vrasësit serial Entoni Souell.

Qeveria amerikane, ka pasur dikur një "Fond të ndërgjegjes", ku qytetarët mund të dërgonin para nëse ndiheshin fajtorë për diçka. Shuma më e madhe e hedhur ndonjëherë ishte në vitin 1909, kur dikush dërgoi 18.669 \$ (ose 490.000 \$ me kursin e 2015-ës).



KOPRRACI

Pasi hanë petulla për mëngjes, mysafiri i fshinë duart.
- Merr, merr, i thotë i zoti i shtëpisë.
- Jo, faleminderit, u ngopa, i mora tri copë, thotë mysafiri.
Koprraci përgjigjet: Jo ti i more pesë petulla, po merr se paska ende.



Nëse lutesh të bjerë shi, duhet ta pranosh edhe baltën, gjithashtu.
(Denzel Washington)